

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5701  
E mërkurë, 13 shkurt 2019  
çmimi 0.40 €

Haradinaj: ShBA-ja  
po kërkon pezullimin  
e taksës, por taksa  
do të mbetet ■ FAQE 3



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ ■ FAQE 4-5



## RAPORTET STRATEGJIKE MES VENDEVE NUK VAREN NGA ÇËSHTJET PERIFERIKE

Politologu Belul Beqaj ka thënë se raportet strategjike në mes të vendeve nuk varen nga çështjet periferike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova duhet të ketë kujdes në raportet me bashkësinë ndërkombëtare. Sipas tij, vendimmarrja për

çështje strategjike, pa u konsultuar me ndërkombëtarët, është aventuriere. Beqaj ka deklaruar se taksa për produktet serbe mund ta ndalë vetëm përkohësisht dialogun për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. "Taksa mund ta ndërpresë përkohësisht dialogun, por jo

edhe ta ndalojë atë. Për këtë arsye nuk duhet stërmadhuar rëndësinë e saj. Pse të mos i bëhet presion Serbisë për vazhdimin e dialogut për shkak të qindra arsyeve më të rëndësishme që e kanë degraduar dhe po e degradojnë shtetin e Kosovës?", ka thënë Beqaj

## Qeveria ndan 500 mijë euro për festimin e 11-vjetorit të pavarësisë

Gjysmë milioni euro janë ndarë për festimin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ky vendim është marrë në mbledhjen e së martës të Qeverisë së Kosovës. Kabineti qeveritar ka miratuar edhe propozimvendimin për themelimin e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit Kundër Qytetarëve të Kosovës "Bllaca 1999".



Aprovimin e Qeverisë e ka marrë edhe Strategjia e Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile 2019-2023 ■ FAQE 3



Qytetarët nuk e duan kthimin e luftëtarëve të huaj në Kosovë ■ FAQE 7

### AKTUALE

A DUHET PAVARËSINË TA FESTOJMË APO KUFIRIN TA KORRIGJOJMË?

F. 10-11



Behxhet Sh. SHALA -BAJGORA

PRESIDENTI THAÇI PRANON LETRAT KREDENCIALE NGA AMBASADORI I RI I TURQISË F.8

PESË TË VDEKUR NGA VIRUSI H1N1 F.8

### EKONOMI

MË 14 SHKURT PREFIKSI +377 DO TË ZËVENDËSOHET ME ATË +383 F. 8

BQK-ja ANËTARËSOHET NË GRUPIN PUNUES NDËRKOMBËTAR PËR RREZIKUN OPERACIONAL F. 9

### KULTURË

KËSHILLA DHE SUGJERIME NGA KREATORJA E MIRËNJOHUR PEJANE EDONA HAXHIJAJ F. 15



### SPORT

LLUMNICA: T'U BESOJMË TRAJNERËVE VENDËS F. 18

AJAKSI PRET KAMPIONËT E EVROPËS F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Palmer: Shqipëria, shtet aleat i vlerësuar dhe i rëndësishëm i ShBA-së

**TIRANË, 8 SHKURT** - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, gjatë qëndrimit në ShBA, në kuadër të ministerialit të Koalicionit Global Kundër ISIS-it, zhvilloi një seri takimesh me përfaqësues të lartë të administratës, Kongresit dhe Senatit amerikan, si dhe me homologë të vet, ministra të punëve të jashtme të disa vendeve evropiane.

Zëvendësdihmësekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, pasi e uroi ministrin në detyrë, Cakaj, për detyrën e re, vlerësoi kontributin e Shqipërisë në Koalicionin Global Kundër

ISIS-it, angazhimin e Shqipërisë në NATO, si dhe kontributin konstruktiv të saj në Ballkanin Perëndimor për avancimin e agjendës evropiane. Ai theksoi se Shqipëria mbetet aleate e vlerësuar dhe e rëndësishme e ShBA-së. Palmeri e përgëzoi Cakajn për kryesimin e radhës së OSBE-së nga Shqipëria më 2020 dhe e siguroi për mbështetjen e ShBA-së gjatë saj.

Ministri në detyrë, Cakaj, vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm dhe asistencën e çmuar që ShBA-ja i ka dhënë Shqipërisë si në reformat e brendshme, sidomos atë të drejtësisë, ashtu edhe në

agjendën rajonale, evropiane dhe më gjerë. Cakaj i paraqiti Palmerit një panoramë të hapave të ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të pritshmërive për hapjen e negociatave me BE-në në qershor të këtij viti si dhe dinamikën e bashkëpunimit rajonal në formate dy dhe shumëpalëshe.

Në takimin e zhvilluar me kryetarin e Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë në Kongresin amerikan, Eliot Engel, u nënvizua rëndësia e mbështetjes së ShBA-së për hapat e ndërmarra nga Shqipëria në drejtim të reformave si dhe kontributin në bashkëpunimin rajonal.



Ndërsa kongresisti Engel shprehu mbështetjen e ShBA-së në kuadër të partneritetit strategjik

dhe dakordimit të politikave për çështjet e sigurisë në arenën ndërkombëtare.

## NATO-ja do të diskutojë për raportet e ardhshme me FSK-në

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka konfirmuar se në rend dite të takimit ndërministror do të jetë edhe shqyrtimi i marrëdhënieve ndërmjet NATO-s dhe FSK-së dhe ka përsëritur se Kosova duhet t'i respektojë të gjitha obligimet ndërkombëtare, përfshirë edhe marrëveshjen e Brukselit, e cila, sipas Stoltenbergut, thotë se "FSK-ja nuk do të hyjë në veri të Kosovës pa pëlqimin e komandantit të KFOR-it"

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Ministrat e mbrojtjes së NATO-s do të diskutojnë rreth qasjes së Aleancës ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës pas vendimit të Kuvendit të Kosovës për transformimin e kësaj force në ushtri.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka konfirmuar se në rend dite të takimit ndërministror do të jetë edhe shqyrtimi i marrëdhënieve ndërmjet NATO-s dhe FSK-së. Stoltenbergu tha se misioni i KFOR-it do të mbetet i pandryshuar, pasi kjo forcë operon në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. "Është e rëndësishme ta bëjmë dallimin ndërmjet dy

pranive të NATO-s në Kosovë. Misioni i KFOR-it nuk do të jetë i ndikuar. KFOR-i është atje tashmë 20 vjet dhe kontribuon për stabilitetin në Kosovë dhe më gjerë në rajon. Ajo që ne do të vlerësojmë janë aktivitetet jashtë misioneve të KFOR-it që është një tjetër lloj i ndërtimit të kapaciteteve", ka thënë Stoltenbergu, i cili ka konfirmuar se gjatë këtij takimi nuk pritet të merren vendime konkrete.

Kreu i Aleancës Veriatlantike përsëriti se Kosova duhet t'i respektojë të gjitha obligimet ndërkombëtare, përfshirë edhe marrëveshjen e Brukselit, e cila, sipas Stoltenbergut, thotë se



"FSK-ja nuk do të hyjë në veri të Kosovës pa pëlqimin e komandantit të KFOR-it". Sipas agjendës së mbledhjes së ministrave të mbrojtjes, debati për Kosovën do të mbahet të enjten. Pas vendimit të Kuvendit të Kosovës, në dhjetor të vitit të

kaluar, për ta transformuar Forcën e Sigurisë në ushtri, sekretari i përgjithshëm i Aleancës pati vlerësuar se vendimi erdhi në një "kohë të gabuar" dhe kishte njoftuar se Aleanca do ta shqyrtojë përfshirjen e saj në raport me FSK-në. Debati mbi shqyrtimin e

angazhimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës do të mbetet në nivelin e diskutimeve, megjithatë, sipas burimeve të "Radios Evropa e Lirë", nuk përjashtohet mundësia që NATO-ja, gjatë këtij viti, të vendosë të heqë disa fonde për FSK-në.

## Xhaferi: Ratifikimi i protokollit, deri në fund të vitit

**SHKUP, 12 SHKURT** - Slovenia ratifikoi protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Kreu i Partisë Demokratike Slovene në pushtet, Janez Jansa, është shprehur optimist në procesin e ratifikimit të protokollit në të gjitha parlamentet e vendeve anëtare të Aleancës veri-atlantike. Kryeparlamentari Talat Xhaferi, i

cili ishte i pranishëm në procesin e ratifikimit të protokollit, shpreson se deri në fund të vitit protokollin do të ratifikohet nga të gjitha vendet anëtare të NATO-s. "Shpresojmë se deri në fund të vitit protokollin për anëtarësim në NATO, i cili në javën e kaluar u nënshkrua në Bruksel nga ambasadorët e 29 vendeve anëtare, do të ratifikohet në të

gjithë 29 parlamentet dhe pas kësaj ne të bëhemi vendi i 30 i NATO-s me të gjitha të drejtat dhe obligimet që i ka çdo vend anëtar i NATO-s", theksoi Talat Xhaferi. Pas dritës jeshile në komisionet parlamentare, të enjten pritet që protokollin për anëtarësim ta ratifikojë edhe Shqipëria. Deri në fund të muajit pritet që i njëjti të ratifikohet edhe në Parlamentin

bullgar dhe në Sllovakia. Pas përfundimit të procedurave ratifikuese në të gjitha parlamentet, NATO-ja njofton Organizatën e Kombeve të Bashkuara për tejkalimin e konstitit në mes të Greqisë dhe Maqedonisë, ndërsa në samitin e radhës Maqedonia bëhet edhe zyrtarisht anëtare e 30 e Aleancës Veriatlantike.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Qeveria ndan 500 mijë euro për festimin e 11-vjetorit të pavarësisë



Gjysmë milioni euro janë ndarë për festimin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ky vendim është marrë në mbledhjen e së martës të Qeverisë së Kosovës. Kabineti qeveritar ka miratuar edhe propozimvendimin për themelimin e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit Kundër Qytetarëve të Kosovës "Bllaca 1999". Aprovimin e Qeverisë e ka marrë edhe Strategjia e Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile 2019-2023

**EPOKA  
ERE****Shqipe HETEMI**

Prishtinë, 12 shkurt - Qeveria e Kosovës të martën ka ndarë 500 mijë euro për festimin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Këto mjete do të merren nga kategoria e shpenzimeve rezervë. Kabineti qeveritar ka miratuar edhe propozimvendimin për themelimin e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit Kundër Qytetarëve të

Kosovës "Bllaca 1999". Kjo koincidon me 20-vjetorin e krizës së refugjatëve kosovarë në Republikën e Maqedonisë, që ka mbetur e regjistruar në kujtesën e qytetarëve të dy vendeve. Qendra do ta shprehë vuajtjen e popullit të Kosovës dhe zemërgjerësinë e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në këtë krizë.

Aprovimin e Qeverisë e ka marrë edhe Strategjia e Bashkëpunimit me Shoqërinë Civile 2019-2023.

Strategjia është vazhdimësi e strategjisë paraprahe 2013-2017, e cila ndërlihet me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku qeverisja e mirë dhe transparenca janë parime thelbësore për të kontribuar në zhvillimin e institucioneve për përgjegjësi, llogaridhënie dhe transparenca.

Strategjia ka identifikuar katër objektiva strategjike: Rritje të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në bërjen e politikave; Rritje të

llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik të OShC-ve; Zhvillim të praktikave dhe procedurave për kontraktim të shërbimeve publike nga OShC-të; dhe Nxitje të promovimit të vullnetarizmit dhe programeve për interes publik.

Po ashtu, kabineti qeveritar ka emëruar Fatos Makollin koordinator nacional për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Me propozimin e kryeministrit Ramush Haradinaj, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për caktimin e komisionit dhe hapjen e procedurave të punësimit për banorët e shpronësuar të fshatit Hade dhe Shipitullë për vende të punës në

mihjet sipërfaqësore dhe prodhimin të energjisë elektrike. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, komunës së Obiliqit, përfaqësues të KEK-ut dhe përfaqësues të banorëve të fshatit Hade dhe Shipitullë.

Miratimin e Qeverisë e ka marrë edhe nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes për partneritet, tregti dhe bashkëpunim në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Marrëveshja do ta zëvendësonte marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Kosovës dhe BE-së, me qëllim të sigurisë dhe vijimësisë së kushteve të qasjes në treg, që aktualisht janë të zbatueshme në mes të Kosovës dhe Britanisë së Madhe.

## Haradinaj: ShBA-ja po kërkon pezullimin e taksës, por taksa do të mbetet

Pas mbledhjes së Qeverisë, kryeministri Ramush Haradinaj ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilin ka folur për çështjen e taksës ndaj produkteve serbe. Ai ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë duke sugjeruar në vazhdimësi që të pezullohet taksa dhe t'i hapet rruga dialogut. Kjo kërkesë Haradinaj ka thënë se i është përsëritur edhe në takim me ambasadorin amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett. Ai ka theksuar se vazhdimi i dialogut nuk duhet të kushtëzohet me pezullimin apo heqjen e taksës ndaj Serbisë. "Qëndrimi ynë është i qartë, edhe unë dua ta heq taksën komplet, pra jo vetëm ta suspendoj, por kjo është e lidhur me njohjen nga Serbia. Po ashtu, sugjerimi im është që të mos ndërlihen temat. Dialogu ka filluar para taksës dhe asnjëherë nuk është kushtëzuar. Edhe tash nuk duhet të kushtëzohet", ka theksuar ai.



Sipas Haradinajt, marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nënkupton zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura, me njohje reciproke dhe sigurimin e ulësës për Kosovën në Kombet e Bashkuara. Ai ka theksuar se dialogu mund të vazhdojë njëkohësisht me taksën në fuqi. "Sikurse presidenti Trump apo ndonjë autoritet i lartë i thërret dy delegacionet e vendeve për një marrëveshje, ne nuk e pen-

gojmë. I lusim që të punojmë për marrëveshje, mos ta humbin kohën. Por, taksa nuk hiqet pa marrëveshje. Është gabim të jepen premtime të gabuara nga kushdo qoftë, Serbisë apo kujtdo", ka thënë ai.

Haradinaj ka mohuar mundësinë që mbajtja e taksës në fuqi mund ta prishë partneritetin dhe miqësinë në mes të Kosovës dhe Amerikës. "Kjo nuk ka të bëjë me përvojën time me Amerikën. Kjo

ka të bëjë me përvojën 20-vjeçare me Serbinë. Jemi lodhur, dhe kjo i ka kushtuar Kosovës. Taksa mund të jetë pakufi, përjetësisht derisa të arrihet një marrëveshje me Serbinë. Nuk ka asnjë sanksion që na detyron ta heqim taksën. Nuk duhet palët e tjera të llogarisin që po e devijojmë Kosovën, e të na detyrojnë të pranojmë ndonjë ndërrim të kufijve apo territor, veç pse e kemi një Gjykatë Speciale apo çfarëdo tjetër. Apo pse i rrezikohet ulësja ndonjërit prej nesh apo ku ta di unë", ka theksuar Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka shprehur pakënaqësi edhe me deklaratat e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rahman Rama, në lidhje me anulimin e vizitës së generalit amerikan Timothy Orr në Kosovë, që erdhi pas vendimit të Qeverisë amerikane si reagim ndaj taksës. "Gjeneralin Rama e respektoj. Ai është komandant i ushtrisë. Sa më pak që bëhet subjekt i medieve është më mirë.

Nëse ai mendon se është vështirë për ta mbajtur postin, mund të ketë ndonjë djalë apo vajzë të re eprore që mendon se nuk është aq zor ta udhëheqë ushtrinë. Kështu që, nuk ka arsye komandanti të dalë shpesh në media", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se e kupton logjikën pse po ndodh një gjë e tillë në medie dhe opinionin publik. "Ndodh të anulohen vizita ose të shpeshohen vizita. Unë e kuptoj logjikën pse po bëhen kaq të zhurmshme dhe e kuptoj pse mendojnë që ruhet miqësia", ka thënë ai. Kurse sa iu përket deklaratave të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, sipas të cilit, FSK-ja nuk mund të operojë në veri të Kosovës, Haradinaj ka thënë se Kosova i ka ofruar NATO-s një protokoll të ri të operimit për gjithë vendin pa dallim, "nuk ka veri dhe jug". Ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës i ka dhënë mandatin ushtrisë për të vepruar në gjithë vendin, pa dallim.

Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

# Raportet strategjike mes vendeve

Politologu Belul Beqaj ka thënë se raportet strategjike në mes të vendeve nuk varen nga çështjet periferike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova duhet të ketë kujdes në raportet me bashkësinë ndërkombëtare. Sipas tij, vendimmarrja për çështje strategjike, pa u konsultuar me ndërkombëtarët, është aventuriere. Beqaj ka deklaruar se taksa për produktet serbe mund ta ndalë vetëm përkohësisht dialogun për normalizim të marrëdhënies Kosovë - Serbi. "Taksa mund ta ndërpresë përkohësisht dialogun, por jo edhe për ta ndalur atë. Për këtë arsye nuk duhet stërmadhuar rëndësinë e saj. Pse të mos i bëhet presion Serbisë për vazhdimin e dialogut për shkak të qindra arsyeve më të rëndësishme që e kanë degraduar dhe po e degradojnë shtetin e Kosovës?!", ka thënë Beqaj

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Politologu Belul Beqaj ka ftuar liderët institucionalë të Kosovës që të kenë kujdes në raportet me ShBA-në dhe BE-në. Ai ka thënë se vendimmarrja për çështje strategjike, pa u konsultuar me ndërkombëtarët, është aventuriere. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka vlerësuar se një sjellje e tillë e lidërshiptit vendës shpreh mosmirënjohje për kontributin e ndërkombëtarëve për çlirimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. "Raportet strategjike mes vendeve nuk varen nga çështjet periferike. Miqtë dhe armiqtë potencialë duhet të kuptojnë se pavarësia e vendimmarrjes është sprovë e sovranitetit. Marrja e vizës nga ndërkombëtarët, veçmas rishikimi i vendimmarrjes pas çdo reagimi të faktorëve ndërkombëtarë, shkakton infatilitetin politik. Ndërsa vendimmarrja për çështje strategjike, pa u konsultuar me ta, është aventuriere dhe shpreh mosmirënjohje për kontributin e tyre për çlirim dhe shtetndërtim", ka thënë Beqaj. Ai ka deklaruar se taksa për produktet serbe mund ta ndalë vetëm përkohësisht dialogun me Serbinë. Sipas Beqajt, bashkësia ndërkombëtare duhet t'i bëjë presion edhe Serbisë për sjelljet destruktive në raport me Kosovën. "Taksa mund të ndërpresë përkohësisht dialogun, por jo edhe ta ndalë. Pikërisht për këtë nuk duhet për ta stërmadhuar rëndësinë e saj. Pse të mos i bëhet presion Serbisë për vazhdimin e dialogut për shkak

të qindra arsyeve më të rëndësishme që e kanë degraduar dhe po e degradojnë shtetin e Kosovës?!", është shprehur ai. Ai ka treguar se taksa është pasojë e dialogimit të privatizuar dhe aventurier që Kosova e ka bërë deri më tani me Serbinë. "Fatkeqësisht, ajo po përdoret si digë e mbrojtjes së integritetit dhe sovranitetit të vendit në kohë të papërshtatshme, por edhe si instrument i kapitalizimit nga zgjedhjet eventuale. Prandaj, Kosova është në udhëkryq. Megjithatë, më mirë është të mbetet aventura e taksës e Ramush Haradinajt sesa të vazhdojë aventura e Hashim Thaçit për ndarjen dhe zhbërjen e shtetit të Kosovës", ka thënë ai.

**"Epoka e re": Z. Beqaj, kryeministri Haradinaj po insiston në mbajtjen e taksës ndaj mallrave serbe, pavarësisht prej presionit ndërkombëtar. Si e keni parë këtë konsistencë të kryeministrit?**

**Beqaj:** Jam i vetëdijshëm se nuk duhet prishur partneriteti strategjik me ShBA-në por, nëse janë në pyetje vendimet strategjike, nëse pushtetarët e Kosovës nuk mund të marrin vendime të pavarura edhe për çështje të tilla, atëherë çfarë kuptimi kanë pavarësia dhe sovraniteti i shtetit?! Përkundrazi, zyrtarët amerikanë duhet ta inkurajojnë guximin për vendimmarrje të pavarur pavarësisht se taksa nuk arsyetohet. Por, as kushtëzimet eventuale të ShBA-së, apo çdo shteti tjetër ndaj Kosovës. Nëse dikush nga administrata e Trumpit mendon në ShBA se Kosova duhet të marrë vendime vetëm



siç mendojnë zyrtarët e ShBA-së, atëherë interesi strategjik i intervenimit të ShBA-së paska qenë më i rëndësishëm se aspekti humanitar që është përdorur publikisht si argument i intervenimit. Lojaliteti i shtetasve të Kosovës ndaj ShBA-së nuk duhet sprovuar me veprime të tilla, aq më parë kur dihet mirëfilli se pushtetet e pasluftës janë mbajtur më së shumti në saje të mbështetjes amerikane, edhe pse ka pasur raste kur janë toleruar edhe "vjedhjet industriale".

**"Epoka e re": Mosrespektimi i kërkesës amerikane për pezullimin e taksës a mund të ndikojë në raportet Kosovë - ShBA?**

**Beqaj:** Raportet strategjike në mes të vendeve nuk varen nga çështjet periferike. Miqtë dhe armiqtë potencialë duhet të kuptojnë se pavarësia e vendimmarrjes është sprovë e sovranitetit. Marrja e vizës nga ndërkombëtarët, veçmas rishikimi i vendimmarrjes pas çdo reagimi të faktorëve ndërkombëtarë, shkakton

infatilitetin politik. Ndërsa vendimmarrja për çështje strategjike, pa u konsultuar me ta, është aventuriere dhe shpreh mosmirënjohje për kontributin e tyre për çlirim dhe shtetndërtim.

**"Epoka e re": ShBA-ja tashmë veç ka ndërmarrë disa hapa në këtë drejtim. Nuk ia ka dhënë vizën kryeministrit Haradinaj dhe e ka anuluar vizitën e komandantit të Gardës Nacionale të Iowas, Timothy Orr. Në cilat fusha të tjera men-**

# nuk varen nga çështjet periferike



turiere që ka në krye të shtetit një kryetar aventurier. Taksa është pasojë e dialogimit të privatizuar dhe aventurier. Fatkeqësisht, ajo po përdoret si digë e mbrojtjes së integritetit dhe sovranitetit të vendit në kohë të papërshtatshme, por edhe si instrument i kapitalizimit nga zgjedhjet eventuale. Prandaj, Kosova është në udhëkryq. Megjithatë, më mirë është të mbetet aventura e taksës e Ramush Haradinajt sesa të vazh-

dojë aventura e Hashim Thaçit për ndarjen dhe zhbërjen e shtetit të Kosovës.

**"Epoka e re":** A besoni se mund të ndalet faza finale e dialogut Kosovë - Serbi me mosheqjen e taksës?

**Beqaj:** Taksa mund ta ndërpresë përkohësisht dialogun, por jo edhe ta ndalojë atë. Pikërisht për këtë nuk duhet për ta stërmadhuar rëndësinë e saj. Pse të mos i bëhet presion Serbisë për

vazhdimin e dialogut për shkak të qindra arsyeve më të rëndësishme që e kanë degraduar dhe po e degradojnë shtetin e Kosovës?! Agresiviteti i Serbisë për çnjohje të shtetit të Kosovës dhe retorika mohuese janë më të rrezikshme sesa taksa e një shteti që sulmohet nga të gjitha anët në kohën kur zhvillohet dialogu për normalizimin e raporteve. Tekefundit, dialogu mund të vazhdojë, pas zgjedhjeve në Kosovë, Serbi, BE, ShBA... apo jo?!

## Pesë të vdekur nga virusi H1N1

PRISHTINË, 12 SHKURT - Pesë persona kanë vdekur gjatë këtij viti në Kosovë nga gripi, përkatësisht virusi H1N1. Nga ky virus, 13 persona janë të shtrirë në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në gjendje të rëndë shëndetësore. Ndërkaq nga 1 tetori i vitit 2018 në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë raportuar gjithsej 24 725 raste të dyshimta me grip. Me gjithë këto raste, profesionistët shëndetësorë thonë se këto shifra ende nuk janë të përmasave të shpërthimit epidemik. Sali Ahmeti, infektolog, i tha "Radios Evropa e Lirë" se rastet me grip janë shtuar ditë e fundit edhe në spitalet rajonale në Kosovë, por edhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare, derisa rastet e rënda referohen në qendrën

terciare, pra në Klinikën Infektive në QKUK. "Ndonëse incidencë e shtuar, tash për tash nuk janë përmasa të shpërthimit epidemik me serioz. Në klinikë kemi të shtrirë 13 të sëmurë në gjendje të rëndë, me komplikime kryesisht respiratore e me infeksione pulmonare. Ata janë në monitorim dhe shpresojmë se gjendja e tyre do të përmirësohet. Fatkeqësisht, kemi humbur pesë persona nga gripi H1N1, e që kanë qenë në moshë relativisht të re, por që kanë pasur edhe sëmundje të tjera përcjellëse", ka thënë Ahmeti. Edhe në Klinikën Pediatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pediatri Muharrem Avdiu ka bërë me dije se fluksi i fëmijëve me grip është rritur. Ndonëse aktualisht nuk kanë numër të saktë të fëmijëve që kërkojnë

ndihmë, Avdiu potencon faktin se për mungesë të hapësirës aktualisht janë vendosur nga dy fëmijë në një shtrat për trajtim mjekësor. Gjatë këtij viti në shumë vende të rajonit është shpallur epidemi nga influenza e gripit, pasi shumë njerëz kanë vdekur nga ndërlikimet e shkaktuara nga ky virus. Në Bosnjë dhe Hercegovinë tashmë kanë vdekur 36 persona, në Serbi 19 persona, në Mal të Zi 6, derisa në Maqedoni 2 persona. Sido që të jetë, Instituti Kombëtar po përcjell me vëmendje ecurinë epidemiologjike të gripit sezonal në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke shtuar punën në terren. Rastet raportohen nga të gjitha komunat e Kosovës, thonë zyrtarë nga ky institut, derisa shtojnë se asnjëra nuk e kalon pragun epidemik.



doni se mund ta sanksionojë ShBA-ja Kosovën?

**Beqaj:** Kosova është, para së gjithash, produkt i NATO-s dhe rezistencës kombëtare. Pse amerikanët janë zhgënjyer me lidhshimin politik të cilin e kanë mbështetur më shumë ata sesa populli nuk duhet t'i hakmerren idesë për ndërtimin e një shteti të mirëfilltë. Çdo sanksion që drejtohet ndaj lidhshimit do të ishte i justifikueshëm. Por, veprimet eventuale që rrezikojnë zhbërjen e shtetit të Kosovës duhen kundërshtuar pavarësisht

se kush tenton të bëjë këtë. Në Kosovë po krijohet vetëdije e shtetndërtimit. Pavarësisht prej lidhshimit që po e rrezikon për çdo ditë këtë, do të ishte e pafalshme nëse këtë vetëdije e sulmojnë edhe ata që kanë kontribuar më së shumti për krijimin e vetëdijes së shtetndërtimit.

**"Epoka e re":** Nëse Qeveria e Kosovës nuk e heq taksën, cila duhet të jetë rruga për të dalë nga kjo situatë?

**Beqaj:** Kjo është Qeveri aven-

## Telemjekësia me sisteme të avancuara

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Në kuadër të projekteve kapitale të financuara nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar dhe Ministria e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës me sukses ka finalizuar fazën e parë të implementimit të projektit "Avancimi i sistemeve të telemjekësisë". Në këtë fazë është bërë instalimi i sistemit për videokonferenca dhe sistemit të zërit në amfiteatrin e Qendrës Kombëtare të Telemjekësisë në Prishtinë. Po në këtë fazë është instaluar edhe infrastruktura qendrore për menaxhimin dhe ruajtjen e videokonferencave si dhe integrimi i infrastrukturës së vjetër në mënyrë që sistemi të vazhdojë të funksionojë edhe

me sistemet e vjetra derisa të përfundojë faza e dytë e këtij projekti dhe të gjitha sistemet e vjetra në qendrat rajonale të telemjekësisë të zëvendësohen me ato të reja.

Në fazën e dytë, përveç qendrave ekzistuese, do të shtohen edhe dy qendra të tjera rajonale, Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj dhe ai në Vushtri, duke kompletuar kështu integrimin e sistemit sekondar me atë terciar/universitar.

Sistemi mobil i videokonferencave është kompletuar dhe funksionalizuar plotësisht dhe tani mund të përdoret qoftë për qëllime edukimi apo edhe transmetim nga ambiente të ndryshme si sala operacioni.

Amfiteatri është pajisur me sisteme videokonferencash me kualitet të lartë të imazhit dhe zërit, monitor dhe projektor për



të shfaqur në të njëjtën kohë praninë lokale, atë në distancë dhe prezantimet.

Serverët e infrastrukturës qendrore janë instaluar dhe konfiguruar në dhomën e serverëve. Gjithashtu, për t'u përshtatur

me specifikat e sistemeve të reja, në bashkëpunim me ofruesin e shërbimeve të internetit dhe VPN-it, janë bërë konfigurimet dhe përshtatjet e nevojshme të rrjetit. Instalimet fizike si dhe konfigurimet

janë bërë me një nivel të lartë profesionalizmi duke ruajtur njëkohësisht edhe estetikën e hapësirave në të cilat janë kryer këto instalime. Pas përfundimit të instalimeve dhe konfigurimeve është bërë trajnimi i stafit të IT-së për përdorimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Këto trajnime dhe konsultime shtesë po vazhdojnë në varësi të identifikimit të ndonjë problemi të mundshëm.

Sistemet tashmë janë plotësisht funksionale dhe ligjërata e parë e cila është transmetuar me anë të këtyre sistemeve ka qenë nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Harvardit, ku imazhi dhe zëri ishin të kualitetit shumë të lartë dhe ofronin një përvojë krejtësisht ndryshe nga ajo që kishim deri tani.



## FSK-ja, pjesë e ushtrimit fushor dimëror në Turqi

KARS, 12 SHKURT (ER) - Në qytetin Kars të Turqisë ka filluar ushtrimi fushor ndërkombëtar "Winter exercise 19" (Ushtrimi dimëror 19) në të cilin ushtrim po marrin pjesë përfaqësuesit e 13-të shteteve. Ushtrimi "Ushtrimi dimëror 19" ka për qëllim testimin e kapaciteteve luftarake në kushte të dimrit (borë

me trashësi deri 50 cm dhe temperatura deri -20 gradë celsius), si dhe forcimin e ndërveprueshmërisë në ambiente të përbashkëta operacionale.

FSK-ja po merr pjesë me një kontingjent prej shtatë pjesëtarëve të rangut: oficerë dhe nënoficerë-stafi.

Kontingjenti i FSK-së ka zbarkuar më 6 shkurt 2019 dhe i është bashkuar Brigadës së 14-të të Mekanizuar të Ushtrisë Turke, në detyra të ndryshme, si oficerë/nënoficerë stafi etj. Komandanti i Kontingjentit të FSK-së, majori Albert Kuqi, ka thënë se të gjithë oficerët dhe nënoficerët e

FSK-së janë në nivel të detyrës duke treguar profesionalizëm gjatë realizimit të këtij ushtrimi të përbashkët operacionel. "Qëllimi i pjesëmarrjes së FSK-së është që pjesëtarët tanë të trajnohen dhe zhvillojnë shkathtësitë e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimeve, ku përfshinë: qitje

reale nga armët e kombinuara të kalibrave të ndryshme në një operacion konvencional ushtarak, si dhe këto përvoja t'i aplikojmë në vendin tonë në kushte dhe ambiente të ngjashme", ka deklaruar major Kuqi. Ushtrimi "Winter exercise 19" do të përfundojë më 22 shkurt.

## Koordinatori Hoti: Arsimi është kryeagjenda e shtetit

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PEJË, 12 SHKURT - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, ka takuar të martën drejtorët e shkollave të Pejës, të kryesuar nga Drejtori Komunal i Arsimit në Komunën e Pejës, Besim Avdimetaj. Hoti para drejtorëve të shkollave shpalosi Programin Nacional për Rininë dhe njoftoi për fillimin e garës nga java e

ardhshme. "Kam kënaqësinë t'ju njoftoj se që nga 19 shkurti i këtij viti do të fillojë gara në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik. Ne kemi hartuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për garën e cili është duke u shpërndarë nëpër shkollat. Tani është radha juaj që ta filloni procesin e garës, për të cilin jam i bindur se ju do ta bëni si është më së miri", ka thënë Hoti.

Edhe drejtori Avdimetaj në emër të drejtorëve të shkollave

theksoi gatishmërinë për ta mbështetur Programin Nacional për Rininë. "Ne jemi të gatshëm për garën dhe besoj se në komunën tonë programi do të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme", është shprehur Avdimetaj.

Programi Nacional për Rininë përfshin të gjithë nxënësit e nivelit parauniversitar dhe universitar në Republikën e Kosovës në tri fusha: Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik, Dituria dhe Sport.



## Presidenti Thaçi pranon letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Turqisë

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar.

Presidenti Thaçi i ka uruar

mirëseardhje ambasadorit Sakar dhe i ka ofruar mbështetje të plotë në punën e tij për vazhdimin e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve tona. "Do të vazhdojmë të kultivojmë marrëd-

hënie strategjike me Turqinë. Ju falënderoj për mbështetjen që i keni dhënë Kosovës në tri dekadat e fundit", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa ambasadori i ri i Turqisë në Kosovë, Çagri

Sakar, e ka falënderuar presidentin Thaçi dhe ka theksuar se Turqia edhe më tutje do ta mbështesë Kosovën në të gjitha fushat. Presidenti Thaçi ka theksuar se Turqia është një aleate e fuqishme e Kosovës.



# Qytetarët nuk e duan kthimin e luftëtarëve të huaj në Kosovë

Qytetarët e Kosovës nuk dëshirojnë kthimin e luftëtarëve të huaj pasi konsiderojnë se rrezikojnë sigurinë e vendit për shkak të aftësive të tyre luftarake dhe lidhjeve me gupe terroriste. Kështu është thënë në një raport të publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). "Më shumë se 65 për qind e qytetarëve të Kosovës konsiderojnë se luftëtarët e huaj të kthyer nga zonat e konfliktit paraqesin rrezik për sigurinë e vendit", ka thënë Vesë Kelmendi nga QKSS-ja

**EPOKA  
ERE**

**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar raportin "Perceptimet e qytetarëve për kërcënimet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë". Të gjeturat e raportit tregojnë se, krahasuar me vitet e mëparshme, kërcënimet e perceptuar nga ekstremizmi i dhunshëm është ulur për 5 për qind. Në vitin 2018, 70 për qind e të anketuarve besojnë se ekstremizmi i dhunshëm është një kërcënim kombëtar për Kosovën. Rreth gjysma e të anketuarve pajtohen se individët e radikalizuar vazhdojnë ta përhapin ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë. "37 për qind e të anketuarve konsiderojnë se institucionet e Kosovës po e adresojnë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa 30 për qind e të anketuarve besojnë se institucionet e Kosovës duhet të përqendrohen më shumë në këtë çështje", është theksuar në këtë raport.

Në kontekstin rajonal, shumica e të anketuarve nga komunat Gjilan dhe Ferizaj (40 për qind) konsiderojnë se institucionet e Kosovës janë më të përgjegjshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se një nga sfidat kryesore të përpjekjeve për riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer është të rritet vetëdijesimi mbi rëndësinë dhe përgjegjësinë e institucioneve dhe shoqërisë për të ndihmuar në rehabilitimin e të kthyerve nga Siria dhe Iraku.

Statistikat tregojnë se shumica e grave dhe fëmijëve janë ende në zonat ose kampet e konfliktit, por duan të kthehen në Kosovë. Ndërkaq të anketuarit nga Prishtina dhe Gjakova (30 për qind) kanë perceptime të ulëta mbi punën e institucioneve të Kosovës për luftimin e ekstrem-

izmit të dhunshëm. "Më se gjysma e të anketuarve nuk do t'i pranonin luftëtarët e huaj të kthyer (LHT) në komunitetin e tyre. Në krahasim me burrat e anketuar, gratë e anketuara i konsiderojnë burrat e kthyer nga konflikti si rrezik më të madh për sigurinë e vendit. Të

anketuarit shprehën qëndrime pozitive ndaj grave dhe të miturve të kthyer nga zonat e konfliktit", theksohet në raportin e QKSS-së, ku autore është Vesë Kelmendi. "Më shumë se 65 për qind e qytetarëve të Kosovës konsiderojnë se luftëtarët e huaj të kthyer nga zonat e konfliktit paraqesin rrezik për sigurinë e vendit", ka thënë Vesë Kelmendi nga QKSS-ja.

Sipas këtij raporti, besimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet fetare rezultoi më i lartë sesa në Qeverinë, Kuvendin, gjykatat, prokurorinë dhe komunat. "Qytetarët kanë

besim më të ulët ndaj mediave, të cilat luajnë rol të rëndësishëm për përhapjen e kundërme-sazheve ndaj rrëfimeve të ekstremizmit të dhunshëm. Shumica e të anketuarve përdorin televizionet private si burim kryesor informacioni. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga Mitrovica e Veriut përdorin platforma mediatike online për t'u informuar. 56 për qind e praktikuesve myslimanë kanë besim ndaj Bashkësisë Islame, ndërsa 76 për qind e të anketuarve katolikë ndanin besimin ndaj Kishës Katolike në Kosovë", është thënë në raportin e QKSS-së.



## BIK-u merr përsipër mjekimin e Taunita Hoxhës

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Nën organizimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, të martën është nisur për mjekim

në Stamboll, Taunita Hoxha, e cila është aksidentuar ditë më parë në Prishtinë. "Dërgimi i saj u bë me avion të veçantë dhe do

të trajtohet në Spitalin Universitar 'Bezmi Alem'. Kjo është arritur si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit

që ka nënshkruar Kryesia e BIRK-ut me Drejtorinë e Vakëfeve të Republikës së Turqisë. Kryesia e BIRK-ut i dëshiron shërim sa më

të shpejtë znj. Tuainta Hoxha si dhe kthim sa më të shpejtë pranë familjes", është thënë në njoftimin për media të BIK-ut.

# BQK-ja anëtarësohet në Grupin Punues Ndërkombëtar për Rrezikun Operacional

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është anëtarësuar në Grupin Punues Ndërkombëtar për Rrezikun Operacional (International Operational Risk Working Group - IORWG). Me këtë anëtarësim, BQK-ja do të përfitojë nga pjesëmarrja aktive në ngjarje të ndryshme, nga udhëzimet dhe praktikave më të mira të administrimit të rrezikut operacional që ky grup i zhvillon. International Operational Risk Working Group është i dedikuar për avancimin e menaxhimit të

rrezikut operacional në industrinë bankare qendrore. Ky grup është bërë një forum i rëndësishëm në industrinë globale të bankave qendrore për inovacionin, hulumtimin, të mësuarit kolektiv dhe shkëmbimin e praktikave të shëndosha dhe të mira. Grupi Punues Ndërkombëtar për Rrezikun Operacional u krijua në tetor të vitit 2005 me propozim të Bankës së Spanjës, me të cilin u pajtuan edhe shtatëmbëdhjetë bankat qendrore, ndërsa sot ky grup përbëhet nga 95 banka qendrore anëtare.



## ATK-ja dhe Dogana koordinojnë aktivitetet e përbashkëta



PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka pritur të martën në takim drejtorin e Doganës së Kosovës, Bahri

Berisha. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i vazhimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për aktivitetet e përbashkëta për luftimin e ekonomisë joformale, e cila, sipas drejtorit Murtezaj, në

shkallë të madhe dëmton interesat fiskale të Qeverisë, duke shkaktuar zvogëlimin e të hyrave për buxhetin e shtetit. Kjo, gjithashtu, dobëson infrastrukturën shtetërore si dhe aftësinë e

saj për të ofruar shërbime më të mira publike. Ndërsa drejtori i Doganës së Kosovës e ka uruar drejtorin Murtezaj për pozitën e re dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm.

Drejtorët e dy institucioneve theksuan rëndësinë e vazhimit të bashkëpunimit si dhe koordinimin e aktiviteteve mes dy institucioneve kryesore për mbushjen e buxhetit të shtetit.

## Më 14 shkurt prefiksi +377 do të zëvendësohet me atë +383

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Kompania "Vala" ka bërë me dije nëpërmjet një njoftimi se nga 14 shkurti pre-

fiksi +377 do të zëvendësohet me atë +383, me ç'rast thirrjet me prefiksin +377 nuk do të jenë më të

mundura. "Lusim të gjithë konsumatorët tanë që të ndërrojnë mënyrën e formimit të numrit gjatë

komunikimit nëpërmjet operatorit 'Vala', është thënë në njoftimin për media.





# Lluka: Kam kërkuar auditim edhe për katër ndërmarrje të tjera



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shtyrë për një ditë tjetër shqyrtimin e raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2017. Kjo shtyrje erdhi pasi deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se nuk është e arsyeshme të diskutohet për raporte të vitit 2017, kur tani jemi në vitin 2019. "Më duket komplet e paarsyeshme ta diskutojmë raportin e vitit 2017 kur jemi në vitin 2019. Nuk ka kurrfarë kuptimi për të diskutuar për vitin 2017 pa pasur informatë se çfarë ka ndodhur në vitin 2018. Ne e dimë

se vetëm muajt e fundit në Telekom numri i punëtorëve është rritur për 100", ka thënë Bajrami. Ajo ka kërkuar sqarime dhe për kredinë që do të merret për ristrukturimin e Telekomit të Kosovës.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë kredia prej 25 milionë eurosh për Telekomin nga Banka Botërore merret me garanci nga Qeveria, mirëpo paguhet nga Telekom.

Ndërkaq deputeti tjetër i LDK-së, Lutfi Zharku, ka kërkuar nga ministri i Zhvillimit ekonomik, Valdrin Lluka, që deri më 15 shkurt të sillen raportet e vitit 2018. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se dhjetë ndërmarrje nga 16 në tërësi operojnë me fitim dhe janë të

qëndrueshme, ndërkaq gjashtë prej tyre nuk janë në gjendje të mirë. "Katër ndërmarrje në vitin 2018 janë audituar më shumë me kërkesën time. Në vitin 2017, edhe pse ka pasur një punësim të vogël, ndërmarrjet kanë operuar më mirë. Në vitin 2017 kanë qenë dhjetë ndërmarrje që kanë operuar mirë krahasuar me vitin 2016. Janë pesë kompani që kanë operuar me humbje. Subvencionet janë zvogëluar për pesë milionë euro, ndërkaq investimet kapitale kanë rënë", ka thënë Lluka, duke shtuar se ka kërkuar auditim edhe për katër ndërmarrje të tjera. Sipas tij, Posta dhe Telekom vazhdojnë të jenë sfida kryesore. "Telekomi vazhdon të jetë sfida kryesore. Ne jemi në proces të përgatitjes së terrenit për privatizim të

Telekomit. Synimi ynë është të ristrukturohet. Po ashtu, edhe Posta vazhdon të jetë me të njëjtat probleme. Posta vazhdon të mbetet e varur nga qiraja pasi për të paguan Telekom. Dhjetë prej ndërmarrjeve janë të qëndrueshme, kurse gjashtë ndërmarrje janë mjaft keq", u shpreh ministri Lluka, duke shtuar se edhe ndërmarrja "Trepça" subvencionohet me 3-4 milionë euro. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka thënë se të gjitha problemet e ndërmarrjeve publike vijnë nga keqmenaxhimi dhe mbushja me militantë partiakë. Ai e ka quajtur të pakuptimtë marrjen e kredisë për Telekom pasi, sipas tij, kjo e fundit po planifikon të privatizohet. "Mendoj se problemi më i madh sa iu përket

ndërmarrjeve publike është ideologjia e Qeverisë. Ideologjia e saj është që ndërmarrjet publike nuk funksionojnë dhe të gjitha problemet na rrjedhin prej këtyre koncepteve të Qeverisë. Shkatërrimi i PTK-së vjen nga keqmenaxhimi dhe mbushja me militantë partiakë. Ajo që duhet të bëjë Qeveria është ta heqë keqplanifikimin dhe ndikimin politik. Është e dhimbshme se si Telekom është zhvlerësuar. Raporti për ndërmarrje publike duhet të jetë më shumë se kontabilitet. Sa i përket kredisë, qysh është e mundshme të merret kredi nëse Qeveria po mendon ta privatizojë. 25 milionë euro kredi për një ndërmarrje kur je i bindur se ka për të falimentuar! Kjo bëhet veç për t'ua zgjatur pagat militantëve", ka thënë Konjufca.

## Industria e gastronomisë ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin ekonomik

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës. Ai ka thënë se që nga marrja e detyrës së ministrit ka premtuar se do të jetë zë i bizneseve në Qeverinë e Kosovës. "Industria e gastronomisë në vendin tonë është e treta më e madhe në Kosovë. Gastronomët

e Kosovës janë kontribuues të mëdhenj në akrën e shtetit, por edhe në punësimin e qytetarëve tanë. Prandaj jam i fokusuar që kërkesave të tyre t'u japim zgjidhje, duke respektuar banorët, edhe duke stimuluar zhvillimin e kësaj industrie e cila ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë Endrit Shala, ministër i Tregtisë dhe Industrisë.



# A DUHET PAVARËSINË TA FESTOJMË APO KUFIRIN TA KORRIGJOJMË?!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

Taksa me maska: Kosova, si të vetmen masë mbrojtëse ndaj Serbisë fashiste, vendosi taksë prej 100 % për mallrat e Aleksandar Vuçiqit dhe Dodigut, çetnikut të Bosnjës. Realisht, masa ishte një përgjigje politike e Kosovës ndaj sabotimit që po ia bën Serbia në të gjitha dimensionet e që për këtë po e ka përkrahjen e mashtruesve të Brukselit, mafiozes politike Frederika Mogerini dhe rrenacakut bredhës, Johannes Han. Në Kosovë kundër taksës fuqishëm janë deklaruar dy individë me një të kaluar të lavdishme politike dhe kombëtare: presidenti Hashim Thaçi, që dikur u ka shërbyer shqiptarëve, Kosovës dhe Shqipërisë dhe Ramiz Kelmendi, që e ka një të kaluar krejtësisht të kundërt me atë të Thaçit, duke mos i shërbyer as shqiptarëve, as Kosovës, kurse për Shqipërinë nuk e besoj se ka dëgjuar më parë! Kadri Veseli, dhe sidomos Enver Hoxhaj, 100 % e morën atësinë dhe mëmësinë për taksën 100 % kurse tani, pasi janë ngritur temperaturat e që kanë ndikuar në shkrirjen e borës, kanë shumë mundësi ta bëjnë punën skllotë. Kadria po kërkon pezullimin e taksës për 120 ditë, kurse Enveri nuk po dëgjohe fare, pasi në vend të taksës e ka vendosur maskën! Kryeministrit Haradinaj i kanë mbetur patatet e skuqura dhe përvëluese në duar dhe, përkundër vuajtjeve të Tantalit, ende po i mban! Tash është bërë ekip i tërë që po e kundërshton taksën 100 %, nga administrata Trump e deri te

musteqoshi Bolton, në kokë të të cilit po betohen Aleksandar Vuçiqi, Ivica Daçiçi dhe Hashim Thaçi. Madje, dyshi kriminal nga Serbia, Vuçiq - Daçiçi, po nguten të arrihet një marrëveshje gjatë sundimit të dyshes Trump - Bolton për faktin se duket të kenë siguruar mbështetje të favorshme për Serbinë e që është përcaktuese për mbi-jetesën politike të tyre për faktin se në Beograd dhe qytete të tjera të Serbisë, për muaj të tërë ka protesta kundër autokratit Vuçiq, siç po cilësohet nga protestuesit. Në Kosovë e kemi një situatë tjetër sa iu përket protestave, po mungon kapaciteti dhe kondicioni afatgjatë për organizimin e tyre! Lëvizja Vetëvendosje organizimin e protestave e ka ndërlikuar me procesin e shtatzënisë duke organizuar protesta në çdo nëntë (9) muaj. Sunduesi i botës dhe gjithësisë, Amerika, së fundi, posaçërisht dueti Trump dhe Bolton, e kanë një dashuri të rafinuar për "Plazma Keksin" dhe ujin "Rosa", prandaj kanë filluar t'i fusin sanksionet një shteti shumë të fuqishëm që po e rrezikon në politikë globale, ekonomike dhe politike. Edhe ai shtet fillon me shkronjën K, por nuk është Kina, siç realisht edhe mund të pritet, por është Kosova, e lodhur fare për momentin dhe me pak gjasa të forcohet në një të ardhme të afërt. Duket se keksin e kanë parë në tavolinën e njërit prej këshilltarëve të presidentit Thaçi në takimet e fundit ku, sipas presidentit: "Të gjithë amerikanët flisnin me një zë apo se ishin alter ego e mendimeve të Thaçit dhe Vuçiqit...". Kurse ujin "Rosa" e kanë parë mbi tavolinën e tajkunit Kelmendi, mendermethënë deputet, kur gjatë një deklarimi publik urbi et orbi, sikur Papë Françesku në sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan, në emër të patriotizmit fliste se duhej të hiqej taksa 100 %, pikërisht në të njëjtat valë me bashkëpatriotin Hashim Thaçi,

president apo pronarin real të Kosovës. Është interesant përputhshmëria e mendimeve, kërkesave si dhe motiveve për heqjen e taksës 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja të dyshes Vuçiq - Daçiçi, Thaçi - Kelmendi, Mogerini - Han dhe Trump - Bolton. Pastaj, për heqjen e taksës janë disa deputetë dhe deputete, krenarë dhe krenare të PDK-së, e tërë Lista Srpska, me babën Putin, disa "biznesmenë" kosovarë apo ramiza të vegjël si dhe ata që në një mënyrë apo tjetër janë pjesë e kotillës politike të Hashimit apo përfitues të grahdit që thuaja është e njëjta gjë.

**Po pse e bëjnë këtë dhe cili është fati i taksës apo taksambrojtësve:** Mendoj se taksa e ka arritur qëllimin politik, kombëtar, ekonomik, sensibilizues, mobilizues dhe psikologjik ndonëse është shumë e vonuar. Kjo taksë është dashur të jetë në kokën e çdo shqiptari si pjesë e vetëdijes dhe ndërgjegjes njerëzore, kombëtare dhe morale, që nga përfundimi i luftës dhe, po të ishte kështu, do ta kishim një situatë krejtësisht tjetër. Sot nuk do të flisnim as për taksën e as për korrigjimin e kufijve dhe nuk do të vuanim për viza. Kjo do të ndodhte po ta kishim një klasë politike që e kupton alfabetin elementar të politikës. Këtë klasë politike nuk e kishim dikur sikur që nuk e kemi as sot. Prandaj, 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe 11 vjet pas shpalljes së pavarësisë, po pranojmë të bisedojmë për kufij dhe në këtë mënyrë po e shkërdhejmë kuptimin e pavarësisë së Kosovës. Po të flasim pak për çiftet e përfollura më lart, për kërkesat dhe motivet e tyre.

1. Çifti shovinist Vuçiq - Daçiçi. Që të dy e kanë një të kaluar kriminale, shoviniste dhe gjenocidale. Aleksandër Vuçiq është pjellë e spermës politike, shoviniste dhe paramilitare e Vojislav Sheshelit nga i cili as sot, ndonëse nuk janë në

njëjtën parti, politikisht janë në valë të njëjta. Ivica Daçiçi ka qenë spermatozoid politik, ideologjik, shovinist dhe paramilitar i kasapit të Ballkanit, Sllobodan Millosheviq. Afërsia e madhe me të dhe përpjekja të bëhet si Millosheviqi ia kanë dhënë epitetin, Malli Slloba (Slloba i vogël). Që nga përfundimi i luftës nuk kanë lënë guri pa lëvizur për ta dëmtuar Kosovën dhe shqiptarët, kurse promovimin e karrierës politike e kanë bërë mbi krimet ndaj shqiptarëve, mbi varrezat masive në Batajnicë dhe Petrovo Sello, duke u shndërruar në viktimë. Transformimi me një alkimi të përkryer, nga kriminel masiv, në viktimë! Slloba i Vogël apo Ivica Daçiçi, sidomos kohën e fundit, mbahet mend si partner i Behgjet Pacollit që bashkërisht po punojnë kundër njohjeve të Kosovës, si shtet i pavarur dhe sovran sikur që e kanë shpikur një dukuri që deri më tani nuk ka qenë e njohur në diplomaci: tërheqja e njohjeve apo afirmim i ç'njohjeve. Në këtë fushë kanë treguar sukses të paparë, i kanë siguruar, së bashku, 12 ç'njohje të Kosovës. Aleksandar Vuçiqi është më dinak se Slloba i vogël sepse deklarohet se është për kompromis historik me shqiptarët dhe për këtë nga bashkësia ndërkombëtare kërkon diçka konkrete për të pasur arsye të dalë para popullit serb. Nuk kërkon shumë përveç nja 20 % të territorit të Kosovës. Modest është i biri i Fahriut! Ky çift kriminal i ka dy kërkesa: vazhdimin e bisedimeve sipas kushteve të Serbisë dhe heqjen e taksës prej 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Marrëveshja e cila sigurisht është në dobi të Serbisë do ta sigurojë mbi-jetesën politike dhe fizike të dyshit fashist, Aleksandar Vuçiq dhe Ivica Daçiçi.

2. Çifti patriotik Hashim Thaçi - Ramiz Kelmendi. Hashim Thaçi, presidenti aktual i Kosovës, është hermafrodit tipik politik; kur i duhet paraqitet si luftëtari

kryesor dhe themelues i UÇK-së dhe, kur nuk i pëlqen, paraqitet si staf civil i UNHCR-së apo hartues i Rezolutës 1244. Si shef i Karl Bildit dhe Kai Aides. Si rektor i Ban ki Munit. Ramiz Kelmendi ka pësuar një ndryshim që as me teorinë e Darvinit nuk mund të shpjegohet; nga një zvarranik përfitues, përmes parave u bë tajkuni numër një në Kosovë dhe tash, për disa mandate, u bë, mendermethënë, deputet i Kuvendit të Kosovës. Tash, me një dinakëri politikani dhe grabitqari ekonomik, po angazhohet për heqjen e taksës duke përdorur si profakturë, miqtë ndërkombëtarë dhe letrën e presidentit Trump. Si çdo mashtrues. Hashim Thaçi ishte një ndër historianët e rrallë që me aktivitetin e dikurshëm u bë pjesë e historisë dhe pati mundësi të bëhet një ndër personat kryesorë të historisë shqiptare. Ka ende mundësi, nëse mbledh mend. Por, si po deklarohet publikisht, për kompromis të dhimbshëm, korrigjim të kufijve, këmbim të territoreve, Hashim Thaçi, nëse do të përfundojë siç po deklarohet, do të bëhet pjesë e errët dhe negative e historisë shqiptare. Do të bëhet njeriu më i urryer në Kosovë. Kurrë nuk ka qenë më lehtë të mbrohet Kosova se tani kur jemi të pavarur dhe e kemi Kushtetutën. Vetëm duhet të respektohet Kushtetuta e Kosovës, asgjë më shumë. Duhet të lihen përrallat se do ta marrim Luginën e Preshevës dhe nuk do të japim asgjë. As rezidentët në Shtime nuk e besojnë këtë, përveç Xhevë Izmakut që po e përkrah dhe disa injorantëve që e kanë humbur rrugën aksidentalisht, duke u bërë deputetë, ministra dhe bartës të posteve të tjera. Kushtetuta e Kosovës shprehimisht mbron kufijtë e Kosovës nga çdo lakmitar i jashtëm, por duket të jetë e pafuqishme ndaj Hashimit dhe hashimëve. Shumë besoj se Hashimi është më i palumturi në këtë proces dhe se të gjitha

veprimet po i bënë për t'u mos arritur marrëveshja sepse, nëse ndodh kjo, do të jetë humbësi më i madh, në të gjitha aspektet. Hashim Thaçi duhet të dalë para popullit, ta tregojë të vërtetën, të mos hyjë llugave, të mos përmendë dhe të mos pranojë kurrfarë ndryshimi të kufijve dhe në këtë mënyrë do t'u kthehet rrënjëve - popullit dhe do ta fitonte përkrahjen e popullit. Fotografia me Trumpin dhe Vuçiqin është si çështja e orgazmës, shpejt kalon dhe ndjenja e kënaqësisë është e papërsëritshme. Madje, për më keq, bëhet e neveritshme. Kështu do të ndjehej Thaçi pas nënshkrimit eventual të Marrëveshjes me Vuçiqin. Hashim Thaçi duhet të distancohet nga idiotët që dalin në medie dhe deklarojnë se në variantin e mirë Kosova humbet vetëm 2.2 % të territorit të Kosovës, kurse në variantin më të keq i humb 4.4 % të territorit të Kosovës. Le ta gjejë një idiot gazetar që thotë se Kosova fiton diçka e jo vetëm se humb! Nëse Hashim Thaçi detyrohet t'i marrë gërshtë për t'i korrigjuar kufijtë (vetëm të Kosovës) atëherë le të këmbëngulë se këto gërshtë do t'i presin edhe kufijtë e Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe të Greqisë. Atëherë do ta fitonte përkrahjen e të gjithëve! Duhet t'ua bëjë me dije "rrobaqepëve" ndërkombëtarë faktin se nëse lëvizin kufijtë e Kosovës, asnjë serb nuk do të ndjehej i sigurt në jug të lumit Ibër sikur që Kosova nuk do të merrte përgjegjësi për sigurinë e tyre apo objekteve fetare. Ky do të jetë çmimi nëse duan t'i marrin tokë Kosovës. Ose duhet të caktohet kufiri sipas parimit etnik në Ballkan, ose duhet të respektohen kufijtë ekzistues dhe të punohet për respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në përputhje me dokumentet ndërkombëtare e jo sipas dokumenteve të Marti Ahtikarit dhe kriminelëve të

ngjashëm. Edhe çifti patriotik Hashim Thaçi dhe Ramiz Boro Kelmendi janë për vazhdim të dialogut dhe heqjen e taksës 100 %, sikur edhe Vuçiqi dhe Daçiqi. Edhe çifti patriotik këtë e përdorë për mbijetesë politike, fizike dhe biznesore. Marrëveshja eventuale shpejt dhe shpejt me Serbinë do t'ia hajë kokën politike Hashim Thaçit, kurse prolongimi i kësaj marrëveshjeje për më vonë dhe përmirësimi i pozitës negociuese të Kosovës do t'i siguronte edhe një mandat presidencial Hashim Thaçit. Kurse tajkuni Kelmendi do ta ngjyjë në të gjitha sistemet sikur që e ka bërë deri më tani. Një politikë e drejtë fiskale dhe sociale këtij tajkuni do t'ia siguronte perspektivën e Al Kapones të cilin autoritetet amerikane nuk patën mundësi për krimet e shumta dhe makabre, por e burgosën për evazion fiskal!

3. Çifti mashtrues Frederika Mogerini - Johannes Han. Ky çift ka edhe disa muaj mandat pas të cilit do të detyrohen ta ndërrojnë grazhdin. Besoj se Johannes Han do të përfundojë në grazhdin e Serbisë, kurse Mogerini si trafikante. Duke e parë situatën, ky çift mashtruesish po bën përpjekje ta përshpejtojë arritjen e marrëveshjes, duke e mashtruar Kosovën. Merreni me mend sa gënjen për viza e ç'do të bënin për një interes më të madh! Edhe këta mbijetesën e ardhshme e ndërlikojnë me vazhdimin e bisedimeve dhe heqjen e taksës. Për këtë, gënjeshtari bredhës Johannes Han ka ardhur në Prishtinë për t'i bërë presion kryeministrit Haradinaj, kurse Beogradit gjatë tërë kohës së mandatit ia ka lëmuar qimet e prapanicës!

4. Çifti që e sundon botën, Trump - Bolton. E tash është koha ta palosë pakëz bishtin si Milaimi. Ndoshta edhe më shumë! Donald Trump ka prob-

leme me Prokurorinë e Shtetit amerikane e jo me Ramushin. Sipas deklaratave të një kandidate demokrate për zgjedhjet e ardhshme presidenciale të vitit 2020, perspektiva e Donald Trumpit është burgu, në Sing-Sing, San Kuentin apo Kaliforni, nuk ka shumë rëndësi. Po hetohet shkaku se ka lejuar dhe pranuar ndërhyrjet e Rusisë në zgjedhjet e fundit amerikane. Shumë bashkëpunëtorë të Trumpit Prokurori amerikan i ka dërguar në Dubravën amerikane. Si parashikues, gjashtë muaj para zgjedhjeve amerikane kam deklaruar se Trumpi do të bëhet president i Amerikës e që nuk nënkupton se kam besim tek ai. Nuk i besoj aspak sikur edhe Boltonit që kurrë nuk e ka përkrahur pavarësinë e Kosovës. Edhe nëse kurrë nuk do të më japin vizën. Edhe këta i kanë dy kërkesa: vazhdimin e bisedimeve me Serbinë dhe heqjen e taksës 100 %, të cilën e vendosin ata vetë kur të duan edhe ndaj partnerëve dhe shteteve mike. Po e përdorin taktikën e rusëve të cilët, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ua shkërdhenin gratë shteteve që i kishin çliruar me argumentin: "Ja te oslobodill, ja te jeball - unë të kam çliruar dhe unë kam për të shaluar..."

#### Ramushi dhe taksa, pa maska:

Po thonë se taksa që e kanë vendosur të tjerët e që ia kanë lënë në duar Ramushit qenka bërë për shkaqe politike. Mund të jetë edhe ashtu, kur e luani rolin sikur që jeni politikan. Po edhe këta që po e kushtëzojnë heqjen e taksës, për çka e bëjnë këtë?! Mendoni për shkaqe patriotike! E dini se nuk është e vërtetë. Këta nuk kanë guxim të marrin përgjegjësinë dhe fshihen prapa tope.. të Trumpit dhe Boltonit. Ramushi po e paguan një çmim. Ia refuzuan vizën për Lutje të Mëngjesit për t'ia bërë terr para

syve. Nuk e mori vizën dhe tani po lutet kur e vlerëson ai vetë. Jo domosdoshmërisht lutja ndërlikohet me ato të mëngjesit. Erdhi mashtruesi shëtitës, Johannes Han, duke i bërë presion. Mogerini nuk do të dëgjojë më për të. As Vuçiqi e as Hashimi. As ambasadorët amerikanë në Beograd dhe Prishtinë. Edhe gjenerali nga Iowa nuk erdhi në Kosovë, jo se qenkan bërë gabime ushtarake, por që nuk po lejohet "Plazma keksi" dhe uji "Rosa" në Kosovë e që është interes jetik i paktit NATO. Edhe shefi i kësaj aleance ushtarake-politike, Jan Stoltenberg, doli në mbrojtje të "Plazma keksit" dhe ujit "Rosa", duke treguar hidhërim të thellë pse kryeministri Haradinaj nuk po e heq taksën 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Nuk është e pamundur që NATO do të ndërhyjë ushtarakisht ndaj Kosovës, jo duke e bombarduar me bomba, por duke e bombarduar nga ajri me "Plazma keksa", ujë "Rosa" dhe prodhime të tjera serbe. Si pikë koordinuese dhe referuese do ta kenë Çaglavicën dhe Kuçishten, me komandantë Hashimin dhe Ramiz Borën. Tash, nëse Ramushi nuk do të bindet, do të bëhen përpjekje ta shkarkojnë dhe ta bëjnë një qeveri pa Ramushin. Hezitim kryesor e kanë se aktualisht nuk po gjejnë zgjidhje pa Ramushin sikur që paraqet rrezik të madh nëse LV-ja dhe AAK-ja mbesin në opozitë për shkak të kapacitetit të madh destabilizues, por edhe stabilizues. Ai që destabilizon, mund edhe të destabilizojë! Po të isha në vend të Ramushit do ta hiqja taksën 100 % dhe si kusht për vazhdim të bisedimeve do ta shtroja pikërisht temën e taksës 100 %. Nëse i lejohet Serbisë kushtëzimi, pse mos t'i lejohet edhe Kosovës?! Kundër Ramushit do të punohet në dy binarë: i pari, përpjekja për ta bindur ta heqë taksën me kërcënim të shkarkimit; dhe, i

dyti, ta shfrytëzojë masën të drejtë kundër tij, me pretekstin se po na prishë me miqtë ndërkombëtarë, duke në vënë në pozicion kundër krejt botës. Kështu ishte vepruar ndaj Bacës Adem Demaçi që e bënin fajtor për të gjitha viktimat gjatë Konferencës së Rambujesë dhe ndaj të cilit u vërsulën thuaja të gjithë me tituj: "Adem Demaçi kundër krejt botës".

Ka pohime se Ramushi po sillet sikur të ishte pronar i Kosovës kur të gjithë e kanë të qartë se aktualisht tapinë apo pronësinë reale mbi Kosovën e ka Hashim Thaçi, prandaj ai po flet për korrigjim të kufijve dhe pallavra të tjera territoriale. Mendoj se Ramush Haradinaj duhet ta heqë taksën 100 % për mallrat serbe vetëm me një kusht: të bëhet udhëheqës i Ekipit Negociator dhe ta ndryshojë përbërjen e këtij ekipi që aktualisht është kondom i Hashimit, për një përdorim apo disa përdorime. Përrjashtuar këtu tre persona, pjesë e Ekipit Shtetëror Negociator, të tjerët janë sekserë, antikombëtarë, hajdutë dhe kriminelë. Si të tillë ata nuk mund ta përfaqësojnë Kosovën denjësisht, por do të ndjehemi të turpëruar nga ky përfaqësim. Dhe, pa asnjë dyshim, kjo përbërje shumë e dyshimtë dhe kriminale e Ekipit Negociator, me atributin shtetëror, nëse vjen puna ta rrahin pykën me pykë, do ta ulin pazarin shumë më shumë se Hashimi.

*Krejt për fund, lexues të nderuar, A e shihni normale dhe të nevojshme ta festoni 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës kur kufijtë e saj janë nxjerrë në ankand publik, me një çmim qesharak dhe ku pavarësinë e saj po e dhunojmë ne që jemi të thirrur ta mbrojmë atë?! Kufijtë nënkuptojnë integritetin territorial, kurse ky integritet garanton shtrirjen e sovranitetit! A po e bëjnë këtë apo pikërisht të kundërtën?!*



# Ahmeti padit Vetëvendosjen për shpifje

Prishtinë, 12 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka ushtruar të martën padi ndaj Lëvizjes Vetëvendosje për shpifje të vazhdueshme që i ka bërë atij dhe komunës, me theks të veçantë në rastin e furnizimit të shkollave me qumësht për nxënësit. "Ata e kanë shpallur vetën edhe gjykatës! Të gjitha ato që i kanë thënë për furnizimin me qumësht, kanë qenë në kohën kur kemi qenë bashkë, por për ta më nuk ka rëndësi as para publike e as e vërteta. Do të ishte mirë që kjo padi të shkonte për personin që i organizon të gjitha këto shpifje, por ai është mësuar ta gjuajë gurin e ta fshehtë dorën. Prandaj, sot padinë po e bëjmë ndaj partisë së tij", ka thënë Ahmeti në deklarinë e tij për media. Ai ka



shtuar se sa i përket atij tenderi, të gjitha procedurat kanë qenë të hapura dhe Komuna e Prishtinës ka paguar çmimin më të ulët të mundshëm për furnizim me qumësht (p. sh.,

Prizreni, i udhëhequr nga LV-ja, paguan 0.20 centë më shumë për litër).

Ahmeti i ka bërë thirrje gjykatës që sa më parë ta trajtojë këtë rast, në mënyrë që të eliminohen spekulimet për këtë çështje. "Le të veprojë Gjykata ashtu që të ndalen shpifjet, sidomos të atyre njerëzve që janë paraqitur dhe kanë ushtruar, kinse kallëzim penal ndaj meje, të cilët njihen për hajni në Vetëvendosje dhe kanë qenë të dënuar për këtë gjë nga partia e tyre, e sot janë instrumentalizuar për të na sulmuar neve", ka thënë Ahmeti.

"Për secilin qumësht që dërgohet në shkollë ka shënime dhe nënshkrime nga ana e përgjegjësit të shkollës. Kështu, dihet saktë se sa para shpenzohen për këtë furnizim çdo ditë", ka bërë me dije Ahmeti.

## Komuna e Vushtrrisë do të aplikojë në disa fonde të qeverisë japoneze

VUSHTRRI, 12 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka pritur në një takim pune përfaqësuesin e Zyrës Ndërlidhëse të Qeverisë japoneze në Prishtinë, Mark Rodiqi. Pas këtij takimi, Tahiri ka bërë me dije se me Rodiqin ka biseduar për përkrahjen e disa projekteve të komunës që drejton nga qeveria japoneze. "Me z. Mark

Rodiqi, nga Zyra Ndërlidhëse e Qeverisë Japoneze në Kosovë, biseduam për përkrahjen e projekteve të Komunës së Vushtrrisë nga Qeveria japoneze. Janë disa projekte me të cilat komuna do të aplikojë për fonde të Qeverisë japoneze", ka thënë kryetari Tahiri. Qeveria japoneze është donatorja e tretë më e madhe në Kosovë.



## Haradinaj e Gashi flasin për implementimin e plotë të Ligjit për Obiliqin

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashin, me të cilin ka biseduar për implementimin e plotë të Ligjit për

Obiliqin. "Për një dinamikë të përsheptuar të implementimit të plotë të Ligjit për Obiliqin bashkëbiseduam sot me kryetarin Xhafer Gashi. Qytetarët e Obiliqit së shpejti do t'i gëzojnë përfitimet që sjell ky

ligj, i cili do të ndikojë në përmirësimin e gjithëmbarshtëm të mirëqenies dhe ngritjen e parametrevë të ri buxhetorë për këtë komunë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Brenda 24 orëve janë paraqitur 281 raste për trajtim mjekësor në QKUK

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Në Klinikën Emergjente të QKUK-së brenda 24 orëve janë paraqitur 281 raste për trajtim mjekësor. Sipas raportit të punës, 44 pacientë morën shërbimin e nevojshëm

mjekësor në dhomën e kujdesit të avancuar emergjent. Stafit mjekësor ka trajtuar edhe 98 raste në dhomën internistike, kurse në atë ortopedike 69. Gjatë intervalit kohor prej 24 orësh janë realizuar 55 vizita

kirurgjike. Si pasojë e aksidenteve në trafik, 13 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Me udhëzim të mjekëve, 28 pacientë janë shtrirë në klinikën të ndryshme të QKUK-së për trajtim të mëtuqeshëm.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## Pompeo paralajmëron evropianët për ndikimin rus dhe kinez

BRATISLAVË, 12 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, të martën ishte në kryeqytetin e Sllovakisë, Bratislavë, në vijim të një turneu që po zhvillon në disa vende evropiane. Ai mbajti një konferencë me gazetarë, ku i paralajmëroi vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që t'i rezistojnë ndikimit të Kinës dhe

Rusisë. Pompeo përsëriti një paralajmërim që bëri të hënën në Budapest. Ai tha se Shtetet e Bashkuara mund të detyrohen t'i pakësojnë disa operacione në Evropë dhe gjetkë, në se ato vende vazhdojnë të bëjnë biznes me kompaninë kineze të telekomunikacioneve Huawei, ngaqë Uashingtoni ka shqetësime për

motivet e kësaj kompanie në Evropë, sidomos në vendet anëtare të NATO-s dhe BE-së, si dhe për praktikatat e zhvillimit të biznesit prej saj.

Sekretari Pompeo tha se ka shpresa se një konferencë ndërkombëtare për Lindjen e Mesme që do të mbahet sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) në

Varshavë, do të japë rezultate. Shefja e politikës së Jashtme të BE-së Federica Mogherini dhe disa ministra të jashtëm të vendeve evropiane, përfshirë Rusinë, kanë thënë se nuk do të marrin pjesë në konferencën "Ministeriali për nxitjen e paqes dhe sigurisë në Lindjen e Mesme".



## Shmangjet mbyllja e sërishme e Qeverisë amerikane

Demokratët dhe republikanët në Shtetet e Bashkuara arritën marrëveshje në parim mbi sigurinë në kufi, e cila përmban vetëm një pjesë të parave që presidenti Donald Trump i kërkon për ndërtimin e një muri në kufi me Meksikën dhe nuk përmend ndonjë barrierë konkrete

Uashington, 12 shkurt - Demokratët dhe republikanët në Shtetet e Bashkuara arritën marrëveshje në parim mbi sigurinë në kufi, e cila do të financojë Qeverinë amerikane dhe do të shmangë një mbyllje tjetër të saj.

Marrëveshja përmban vetëm një pjesë të parave që presidenti Donald Trump i kërkon për ndërtimin e një muri në kufi me Meksikën dhe nuk përmend ndonjë barrierë konkrete. Marrëveshja duhet të miratohet nga Kongresi dhe të nënshkruhet nga presidenti.

Duke folur pas njoftimit për të, Trumpi nuk e qartësoi nëse do ta mbështesë ose jo marrëveshjen. "Ne do ta ndërtojmë murin gjithsesi", tha ai. Demokratët, që kontrollojnë tani Dhomën e Përfaqësuesve, kanë refuzuar të autorizojnë shumën prej 5.7 miliardë dollarësh që Trumpi e kërkon për ndërtimin e murit. Ligjvënësit u shprehën opti-

mistë se ligji do të miratohet deri të premten, kur edhe mbarojnë fondet për disa agjenci federale. Mbyllja 35-ditëshe e qeverisë, e cila ka përfunduar muajin e kaluar, ka qenë më e gjata në historinë e SHBA-së dhe ka bërë që qindra-mijëra punonjës federalë të mos marrin rroga.

Është llogaritur se mbyllja i ka kushtuar ekonomisë amerikane rreth 11 miliardë dollarë.

Sondazhet kanë treguar se amerikanët e kanë fajësuar Trumpin për këtë.

Marrëveshja u arrit në një takim me dyer të mbyllura, të hënën mbrëma në Uashington, pas disa orësh bisedime. Ajo përfshin 1.3 miliardë dollarë fonde për ngritjen e barrierave fizike në kufi, të gjata 88 kilometra, përfshirë shtylla të çelikut që i ka kërkuar presidenti.

Senatori republikan, Richard Shelby, tha se të gjitha çështjet e pazgjidhura janë zgjidhur. "Besojmë se nëse marrëveshja



bëhet ligj, ajo do ta mbajë qeverinë të hapur", tha ai.

Duke folur në një tubim në El Paso të Teksasit, Trumpi tha se muri do t'i mbronte amerikanët nga kriminelët e dhunshëm dhe drogat e paligjshme. "Muri ndër-

tohet. Do të vazhdojë. Po shkon me një ritëm të shpejtë", tha Trumpi. "Muret bëjnë punë. Muret shpëtojnë jetë", tha ai. Në javët e fundit, Trumpi ka kërçënuar me shpalljen e emergjencës kombëtare nëse

Kongresi nuk i autorizon paratë për murin, por ligjshmëria e një mase të tillë është e diskutueshme. Sipas Kushtetutës amerikane, Kongresi ka fuqinë ligjore t'i miratojë masat buxhetore.

## Nis gjyqi ndaj 12 udhëheqësve separatistë katalanas



Madrid, 12 shkurt - Gjyqi ndaj 12 udhëheqësve separatistë katalanas, të përfshirë në një përpjekje për t'u ndarë nga Spanja në vitin 2017, nisi të martën në Gjykatën Supreme të Madridit.

Të pandehurit, të cilët përfshijnë ish-ministra, ish-kryetarin e Parlamentit të Katalonjës dhe udhëheqës të organizatave pro

pavarësisë - përballen me akuzat si: rebelim, kryengritje dhe keqpërdorim i fondeve publike. Të gjithë ata i mohojnë akuzat kundër tyre.

Në Kataloni, më 1 tetor të vitit 2017, është mbajtur një referendum, në të cilin shumica e atyre që kanë marrë pjesë, kanë votuar për pavarësi nga Spanja.

Parlamenti në Barcelonë më pas

e ka shpallur rajonin autonom republikë të pavarur. Megjithatë, në referendum pjesëmarrja ka qenë e ulët dhe ai është shpallur i paligjshëm nga Gjykata Kushtetuese e Spanjës.

Qeveria qendrore në Madrid ka shtrirë qeverisjen në rajon dhe disa udhëheqës katalanas kanë ikur nga vendi ose janë ndaluar.


## Britania dhe BE-ja vazhdojnë diskutimet për Brexitin

LONDËR, 12 SHKURT - Ministri britanik për Brexitin, Stephen Barclay, tha se Bashkimi Evropian dhe Britania duan që të kenë një marrëveshje të Brexit-it, duke

theksuar se dalja e Britanisë nga BE-ja pa një marrëveshje nuk do të ishte në interes të asnjërës palë. Pas bisedimeve në Parlamentin Evropian, Barclay u tha gaze-

tarëve se kishte shumë vullnet të mirë nga të dyja palët. "Të dyja palët e pranojnë se mungesa e një rezultati nuk është në interes të askujt. Kjo, do të ishte shumë

shqetësuese për Britaninë e Madhe, por edhe për BE-në, kështu që të dyja palët duan të shohin një marrëveshje", tha Barclay.



# Këshilla dhe sugjerime nga kreatorja e mirënjohur pejane Edona Haxhijaj

**PEJË, 12 SHKURT (ER)** - Është një nga kreatorët më të suksesshme të brezit të mesëm, puna e së cilës dallon shumë nga kolegeve të saj. Kjo është kreatorja pejane Edona Haxhijaj, e cila me punën dhe profesionalizmin e saj për vite me radhë e ka dëshmuar veten se është e pazëvendësueshme në profesionin që ka.

Kreatorja pejane Edona Haxhijaj në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka dhënë këshilla dhe sugjerime profesionale se si duhet të duket veshja e një femre gjatë sezonit dimëror, cilat janë gabimet që i bëjnë femrat në kombinimin e ngjyrave dhe në përzgjedhjen e materialit.

**"Epoka e re":** Si duhet të duket veshja e një femre gjatë stinës së dimrit?

**Haxhijaj:** Për stinën e dimrit gjithmonë jemi në kërkim të një pamje të ngrohtë, sigurisht edhe në modë, në mënyrë që të dukemi në hap me trendët e sezonit. Nuk do

këmishët e qëndisura, kristali dhe shkëlqimi janë kryefjala e modës për stinën e dimrit. Për stinën e dimrit janë në modë edhe veshjet me dizajnë folklorike të origjinës së largët, gjithashtu theket vijnë sërish në modë me ngjyrat bardh e zi. Në stinën e dimrit shkojnë edhe veshjet mikse, një laramani ngjyrash dhe kombinimesh, puplat femërore dhe teatrale, si dhe pelerinat.

Sa iu përket kombinimeve, aksesoret gjithsesi na duhen për stinën e dimrit. Shallet e ndryshëm dhe dorashkat apo dorëzat që gjithsesi duken bukur në kombinimin e çfarëdo veshje dimërore. Ngjyrat që do të jenë pretendente për këtë stinë të dimrit janë: ngjyra e portokallit, ngjyra lejla, ngjyra e pastelit, mirëpo disa shtëpi mode propozojnë edhe kontraste të bukura si Prada, veshje të zeza dhe të kombinuara me një vijë të kuqe në copëzat e zeza. Ngjyrat mund të jenë të ndezura: vjollcë në një xhup, sportive dhe ngjyra jeshile



të thotë se në sezonin e dimrit duhet patjetër të vishemi me rroba të trasha. Gjatë këtij sezoni preferohen palltot e zeza, xhinset e gjëra, bluzat e shkurtra me vija, fundet e shkurtra, këmishët e bardha klasike, pantallonat e zeza të shkurtra deri te kavilja e këmbës dhe xhaketat me kuadrate (katrorë) janë shumë shik. Po ashtu, kanatjerja prej mëndafshit, e cila jep një pamje shik dhe seksi, është veshje elegante dhe e rafinuar për ta veshur nën xhakëtë. Gjithashtu, edhe trikot e thurura, çizmet e gjata, pantallonat me kuadrate (katrorë), fustanet e thurura, aksesoret për flokë, xhaketat xhinse dhe fundet prej mëndafshit janë veshje të preferuara për stinën e dimrit. Po ashtu, veshjet me dizajn të lëkurës së kafshëve, argjendi apo gjithçka metalike janë për stinën e dimrit. Gjithashtu, veshjet bust, pra shpatullat jashtë, veshjet me thek,

në një pallto të mbushur me tegele.

**"Epoka e re":** Cilat janë gabimet që i bëjnë femrat që nuk duhet t'i bëjnë gjatë kësaj stine?

**Haxhijaj:** Gabimet më të shpeshta ndodhin në përzgjedhjen e ngjyrave sepse femrat nuk i përshatatin ngjyrat me ngjyrën e tyre të lëkurës apo të flokëve. Shumë prej tyre preferojnë ngjyra gjallëruese gjatë stinës së dimrit. Ky është një ndër gabimet më të shpeshta që bëhet. Femrat duhen ta dinë se çdo stinë ka një gamë ngjyrash dhe kanë hapësirë të mjaftueshme për t'i përshatur me veshjet e tyre. Gabimi tjetër qëndron te madhësia e veshjeve. Secila vajzë duhet të jetë e "sinqertë" me veten kur vendos të blejë rroba. Një numër i madh i femrave mendojnë se veshjet e ngushta janë alternativa e vetme për t'i vënë në pah format e trupit, por ky fakt nuk qëndron



aspak në realitet. Andaj, duhet të vishen me rroba që i bëjnë të ndihen mirë edhe nëse janë të gjëra. Ajo që madhëson veshjen e tyre është stili dhe kombinimi perfekt i ngjyrave dhe i aksesoreve. Mes të tjerash, duhet theksuar se mospërzgjedhja e duhur e këpucëve shumë lehtë mund ta prishë kombinimin e një veshje.

**"Epoka e re":** Çfarë parasheh sezoni i sivjetnë pranverë-verë?

**Haxhijaj:** Askush nuk do të thotë se ju visheni keq nëse stili juaj është i veçantë dhe nëse ndiqet nga një qasje individuale. Ngjyrat trend për sezonin e këtij viti pranverë-verë do të jenë ngjyra purple ultra, jargavani, hija e bukur e të verdhës, jeshilja dhe e kuqja. Ndërkaq, ngjyrat e papritura që pritet të dominojnë në këto dy sezone janë edhe ngjyra kafe dhe blu. Pa dyshim se do të dominojë edhe ngjyra e trëndafilut, ajo e bardha, e

zeza, gri si dhe ngjyra bezhe.

Trendët pranverë-verë 2019-2020 në mesin e veshjeve të sipërme do të jenë: mantelet tunel, xhaketat, mantelet e prera origjinale, xhaketat elegante, xhaketat e shkurtra dhe xhaketat xhinse të cilat janë bërë pjesë e kostumeve moderne. Trendët e pëlhurave do të jenë: lëkura, xhins, mëndafshi dhe sateni.

Në trendin e veshjeve prej xhinsi janë xhinset me variacione të ndryshme, stilet elegante të xhinseve dhe këmishat. Gjithmonë stilistët e kërkojnë gruan e sofistikuar. Stilistët për këtë vit kanë propozuar thajse të gjitha stilet nga klasika te modernia, ekstravaganca apo retro. Ajo që ra në sy ishte kordelja e himn "BON TONIT", por nuk mungonte edhe kapolja e kashtës, kapolet e punuara në dorë, të cilat u prezantuan si simbol i sharmit retro, thurjet me grep, dmth. kapolet për këtë

sezon do të jenë shumë në trend.

**"Epoka e re":** Cilat janë ndryshimet nga vitet e mëparshme të këtyre dy sezoneve?

**Haxhijaj:** Sa iu përket ndryshimeve, nuk ekzistojnë edhe ndryshime të mëdha sepse pothuajse ka disa vjet që kemi thajse tendenca të njëjta të ngjyrave dhe forma të prerjeve. Po ashtu, pëlhurat të cilat po përdoren ndër vite me ndryshime të vogla.


**"Epoka e re":** Cilat janë detajet që e pasurojnë një veshje solemne në këtë sezon?

**Haxhijaj:** Veshjen solemne e bën të veçantë vetë rasti pasi nuk vishet në përditshmëri. Andaj, femrat duhet të jenë të kujdesshme dhe t'i kushtojnë rëndësi edhe detajit më të vogël. Duke filluar nga materiali, këpucët, grimi, si dhe aksesoret përcjellëse që ndikojnë në madhësinë e veshjes solemne.

E jashtëzakonshme

## Ankandi në Nurenberg, asnjë blerës për veprat e Hitlerit

Pesë piktura që mbanin nënshkrimin e Adolf Hitlerit, që u nxorën në ankand në Nurenberg, nuk kanë gjetur asnjë blerës. Polemikën, në fakt, për daljen e tyre në ankand kanë qenë të shumta. Çmimet e pikturave silleshin nga 19 mijë në 45 mijë euro. Por, askush nuk është ofruar për t'i blerë ato.



## BARSOLETA E DITËS



Nëna e nevrkosur fillon t'i bërtasë fëmijës:  
- Ke marrë njëshe në gjuhë dhe letërsi, kjo është e tmerrshme. Çfarë teme patët?  
Djali: Si i kaluat pushimet dimërore.  
Nëna: E çfarë shkrove?  
Djali: Shumë mirë. Faleminderit që pyetët!



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



## FOTO E DITES



Punëtorët indianë shihen duke punuar në zgjedhjen e frutave të quajtura 'Mosambis', të llojit të portokallit të ëmbël. /AFP/

### Në ora 17:30 "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



### Në ora 19:30 "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



### Në ora 22:00 "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

## E rrallë

### Panik në Rusi, arinjtë polarë trembin njerëzit

Një arqipelag i largët rus ka shpallur gjendjen e emergjencës të shtunën që lamë pas një pushtimi nga dhjetëra arinj polarë. Zyrtarët lokalë thonë se 52 arinj polarë ishin parë mes dhjetorit dhe shkurtit përreth Belushia Guba, një zonë në arqipelagun Novaja Zemlya, në oqeanin arktik. Disa nga kafshët kanë sulmuar njerëz dhe kanë hyrë në godina banimi.



 <p><b>DASHI</b> Nuk është një ditë nga ato më të mirat, por gjithsesi do të arrini të merrni ato gjëra që doni nga dita e sotme. Kapni çastet që ju interesojnë.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot ju entuziazmojnë ata persona që kanë një ideal për të ndjekur dhe një projekt ambicioz për të realizuar. Doni t'i keni pranë me çdo kusht.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Raporti në çift do të lëkundet sot nga disa dyshime. Nëse jeni ju ai që duhet të justifikoheni kundrejt partnerit, duhet t'i gjeni fjalët e duhura.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot po mundoheni t'i mbyllni të gjitha punët e ditës sa më shpejt. Ju pret një darkë romantike për të cilën duhet të bëni të gjitha përgatitjet e duhura.</p>	 <p><b>LUANI</b> Dita paraqitet e rrëmujshme me mjaft situata delikate që do ta kërkojnë ndërhyrjen tuaj. Do të shikoni të gjitha mundësitë për të zgjidhur një çështje.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Nuk është se do të ketë ndonjë ulje ose ngritje të madhe dita e sotme. Rutina dhe gjendja juaj disi indiferente thjesht do të lënë gjithçka të kalojë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një ditë interesante ku nuk keni nevojë të komunikoni fare me partnerin sepse merrni vesh në ajër të dy. Bashkëpunimi do të jetë i përkryer.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Nuk po arrini dot të finalizoni një projekt konkret që duhet ta kishit përfunduar tashmë. Nëse hasni pengesa kërkonin ndihmën e ekspertëve.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Pasioni dhe entuziazmi janë një miks i lezetshëm sot që do t'ju bëjë të provoni përvoja shumë të veçanta.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Megjithëse impenjimet e ditës ju mbajnë larg njëri-tjetrit, nëse në familjen tuaj ka një problem të vogël, keni treguar që jeni të gjithë të bashkuar.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot doni të mblidheni me miqtë, por në një vend të qetë larg zhurmave të qytetit. Mjaft ta ndani mendjen dhe do t'ju bashkohen të gjithë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Shumë miqësi dhe energji pozitive rreth vetes sot. Jeni ju që tërhiqni në orbitën tuaj njerëz që kanë gjithmonë mjaft optimizëm brenda tyre.</p>



## Michelle Obama bën befasinë më të bukur në Grammy



Ceremoninë e Grammy Awards 2019 e hapi Alicia Keys si nikoqire dhe solli edhe disa mysafirë specialë për monologun hyrës: Michelle Obama, Lady Gaga, Jennifer Lopez dhe Jada Pinkett Smith. Secila prej tyre mori mikrofonin për ta ndarë

mendimin e tyre se çka kupton muzika për ato. "Muzika gjithmonë më ka ndihmuar ta tregoj historinë time. Muzika na ndihmon të ndajmë vetën me të tjerët, dinjitetin tonë, dhimbjet tona, shpresat tona dhe gëzimet tona", ka thënë Obama.




## Një 49-vjeçare superenergjike si Jennifer Lopez

Jennifer Lopez i la të gjithë pa fjalë me performacën e saj në "Grammy Awards". 49-vjeçarja ndezi skenën me performacën e saj, e cila, për hir të së vërtetës, ishte mahnitëse. Lopez ia dedikoi

këtë performancë nënës së saj, Guadalupe Rodriguez. "Ishte për nënën time. Më vjen të qaj. Është një moment kaq i mirë. Është një ëndërr e bërë realitet", u shpreh Jennifer Lopez.

## 75-vjeçari Mick Jagger shihet me të dashurën pas gjashtë muajsh



Ata nuk janë parë së bashku për pothuajse gjashtë muaj. Megjithatë, Mick Jagger dhe Melanie Hamrick kanë treguar se lidhja e tyre e dashurisë vazhdon të jetë ashtu siç ka qenë, kur u panë

në festën pas ceremonisë së ndarjes së çmimeve Grammys, në Los Angeles. Ikona e Rolling Stones dhe e dashura e tij balerinë u panë vazhdimisht afër njëri-tjetrit gjatë gjithë festës.

## Pete Davidson fshin tatuazhin që e kishte të njëjtë me Ariana Granden



Ndarja e Pete Davidsonit dhe Ariana Grande është përfundimtare. Komediani 25-vjeçar duket se tashmë e ka mbyllur këtë kapitull të jetës së tij. Ai ka bërë një tatuazh që shkruan "i mallkuar" me shkronja të mëdha

mbi një tatuazh që ai dhe Ariana e kishin bërë së bashku. Më 9 shkurt, artisti i tatuazheve, Jon Mesa, ka postuar një fotografi në "Instagram", ku ka treguar punën e tij të fundit për Davidson, një hut me Tootsie Pop në shpinën e tij.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AJAX - REAL MADRID

2-2

TOTTENHAM - DORTMUND

4+

CAEN - NANTES

2

# Llumnica: T'u besojmë trajnerëve vendës

Analisti dhe trajneri i futbollit Ardian Llumnica ka apeluar te klubet në Kosovë që t'u besojnë më shumë trajnerëve vendës për faktin se nuk kanë shumë dallim për nga cilësia me trajnerët e ardhur nga Shqipëria dhe Maqedonia. "Në përgjithësi mendoj se struktura e trajnerëve në Kosovë është e afërt me trajnerët regionalë si nga Shqipëria ose Maqedonia, e veçmas që kemi një gjeneratë trajnerësh të rinj që janë premtues, por që duhet t'u besojmë në punën dhe vizionin e tyre", ka thënë Llumnica

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 SHKURT - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Drita e Gjilanit, ka ndarë të hënën rrugët me trajnerin nga Shqipëria, Shpëtim Duro. Kjo "ndarje" erdhi pas eliminimit të skuadrës gjilanasë nga gara e Kupës dhe mbetjes larg garës për ta mbrojtur titullin në Superligë. I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", analisti i futbollit, Ardian Llumnica, ka thënë se klubet duhet t'u besojnë më shumë trajnerëve vendës, pasi nuk dallojnë shumë për nga cilësia me trajnerët nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Llumnica ka bërë me dije se në përjashtim të Mirel Josës dhe Zekrija Ramadanit, të tjerët nuk i kanë përmbushur pritshmëritë. "Në përjashtim të Zekrija Ramadanit që është shpallur kampion me Trepçën '89 dhe tash është në rrugë të mirë me Feronikelin dhe Mirel Josën që e fitoi edicionin e kaluar Kupën me Prishtinën e që tash është eliminuar nga

kjo garë, lirisht mund të themi setrajnerët e tjerët nuk i kanë arritur t'i përmbushin pritshmëritë. Në përgjithësi struktura e trajnerëve në Kosovë është e afërt, me trajnerë regionalë nga Shqipëria ose Maqedonia. Kemi një gjeneratë trajnerësh të rinj që janë premtues, por që duhet t'u besojmë në punën dhe vizionin e tyre", ka thënë Llumnica, i cili ka pranuar se trajnerët e ardhur në Kosovë kanë sjellë një frymë të re dhe se konkurrenca është shtuar shumë. "Trajnerët nga Shqipëria dhe Maqedonia kanë sjellë një frymë të re të punës dhe menaxhimit, kanë rritur konkurrencën dhe, si të tillë, kanë ndikuar që Superliga të jetë më interesante. Mendoj se edhe klubet duhet të janë të qarta se çka kërkojnë në një sezon. Nuk mjafton një trajner i huaj dhe të kërkojnë rezultate", ka shtuar ai.

Analisti Ardian Llumnica e ka quajtur gabim të madh edhe largimin e trajnerit Bekim Isufi nga skuadra e Dritës, sidomos pas suksesit të arritur në kampionatin e kaluar. "Largimi i Bekim Isufit

nga Drita si kampion ka qenë i panevojshëm dhe aty është parë se diçka nuk është në rregull në menaxhim dhe, si zakonisht që po na ndodh në futbollin tonë, të mos kemi një kampion stabil nga viti në vit, sepse në vitin pasues nga ai i suksesit secila skuadër po çalon, madje po vjen në pozitë të luftojë për mbijetesë. Paraprakisht mendoj se asnjë trajner dhe asnjë klub nuk duhet të bëjë marrëveshje me garancinë për rezultate sepse në sport nuk ka asgjë të sigurt", ka përfunduar Llumnica.

Në muajin e kaluar për "Epokën e re" trajneri Musa Selimi, që është edhe dekan në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, kishte deklaruar se ardhjet e këtyre trajnerëve e pasurojnë futbollin por, sipas tij, klubet duhet më shumë t'u besojnë trajnerëve dhe futbollistëve vendës. "Normalisht se e kanë pasuruar dhe e kanë shtuar konkurrencën në futbollin e Kosovës, por jam ihtar i asaj që t'u besohet më shumë trajnerëve dhe futbollistëve vendorë", kishte deklaruar Selimi.

SHKURT

## Besa transferon Egzon Gashin

Sulmuesi Egzon Gashi ditë më parë për "Epokën e re" deklaroi se vazhdon të jetë lojtar i lirë për faktin se nuk u vetofrohet klubeve. Sulmuesi pejan pranoi se mund të rikthehet te Besa nëse drejtuesit e klubit e konsiderojnë të nevojshme. Marrëveshja u bë publike nga klubi i Besës që të martën me anë të një fotografie në "Facebook" konfirmoi se Gashi në pranverë do të dërsijë fanellën e klubit pejan që aktualisht është pjesë e Ligës së Parë.

## Më 16 shkurt turneu i boksit "Pavarësia"

Federata e Boksit e Kosovës për nder të 11-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës do ta organizojë turneun e 11 ndërkombëtar të boksit, ku do të marrin pjesë boksierë nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia. Meçet e turneut "Pavarësia" do të zhvillohen më 16 shkurt nga ora 12:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

## Pritet paraqitje e mirë nga Klea Vrella dhe Elba Kokaj

Kushtet atmosferike që po mbretërojnë në Qendrën Skitare të Jahorinës në Sarajevë kanë pamundësuar zhvillimin e përgatitjes të martën të skitareve Klea Vrella e Elba Kokaj, para sllallomit të madh që zhvillohet sot (e mërkurë). Klea e Elba po e përfaqësojnë Kosovën në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) 2019 që po mbahet në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore. Vrella dhe Kokaj shpresojnë se do të kenë paraqitje më të mirë. Gara e sllallomit të madh nis nesër në orën 10:00.

## Sot shorti për gjysmëfinalet e Kupës

Sot (e mërkurë) nga ora 12:00 në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës do të bëhet tërheqja e shortit për Digitalb Kupën e Kosovës në futboll. Pjesëmarrjen në gjysmëfinale e kanë siguruar Ballkani, Feronikeli, Trepça '89 dhe Vëllaznimi. Skuadra fituese e Kupës siguron pjesëmarrjen në garën e Ligës së Evropës në edicionin 2019/2020.

## Tahiri, i pafat në Botërorin "Are 2019"

Skitari i Kosovës, Albin Tahiri, ishte i pafat në garën e kombinimit alplik të Kampionatit Botëror "Are 2019". Në lëshimin e parë, Tahiri doli i 52-ti me kohë 1:12.02 sekonda, ndërsa në lëshimin e dytë doli nga shtegu. Garat e ardhshme për Tahirin janë në sllallom dhe sllallom të madh.

## "France Football" zbulon dhjetë skuadrat më të mira

PARIS, 12 SHKURT - Revista prestigjioze franceze "France Football" publikoi listën e skuadrave që i konsideron më të mirat aktualisht në botë. Janë analizuar 85 klube deri në detajin më të vogël, ndërkohë që në listën finale mbetën 30. Dominojnë në 10-shen më të

mirë klubet më të mira angleze. Përveç Manchester Unitedit në vend të tretë, pjesë e dhjetëshes më të mirë janë edhe Liverpooli, Chelsea, Manchester City dhe Arsenal. Nga klubet italiane është vetëm Juventus, ndërsa dy të parët janë gjigantët spanjollë,

Real Madridi dhe Barcelona. Lista e dhjetë skuadrave: Real Madrid (184 pikë), Barcelona (177), Manchester United (151), Bayern Munchen (135), Liverpool (120), Juventus (107), (PSG 94), (Chelsea 91), (Manchester City 89), (Arsenal 88).



## Ajaxi pret kampionët e Evropës

AMSTERDAM, 12 SHKURT - Skuadra gjigante e Holandës, Ajax, e pret skuadrën kampione të Evropës, Real Madrid. Skuadra e Realit ka pasur probleme të shumta në fillim të këtij kampionati, por tash është rikthyer në formën më të mirë dhe synon që ta fitojë ndeshjen e parë në mënyrë që të jetë më afër kualifikimit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Duhet cekur se Realit në këtë ndeshje vjen pas fitores së madhe në ndeshjen ndaj Atletico Madridit (1-3), në La Liga.

Ndërsa Ajaxi ishte në formë të mirë, por në disa prej ndeshjeve të fundit nuk ka pasur shkëlqimin e mëparshëm, madje në ndeshjen e fundit ndaj



Heracles (1-0) ka pësuar humbje (0-1). Skuadra vendëse mund të jetë vetëm pa mbrojtësin Lisandro Magallan, kurse Frenkie De Jong pritet të luajë që nga fillimi. Te mysafirët mungojnë mesfushorët Isco dhe Marcos Llorente. Sonte nga ora 21:00 zhvillohet

edhe ndeshja tjetër në mes të Tottenham Hotspurit dhe Borussia Dortmundit. "Spurs" në këtë ndeshje do të jetë pa lojtarët kryesorë Harry Kane dhe Dalli Alli, por ndeshja pritet të jetë shumë emocionuese për faktin se të dyja klubet sulmojnë shumë.

### TË MËRKURËN TAKOHEN:

21:00 Ajax - Real Madrid  
21:00 Tottenham H. - B. Dortmund

## Toronto ruan kreun në Konferencën e Lindjes

TORONTO, 12 SHKURT - Skuadra e Torontos ruan kreun në Konferencën e Lindjes pas fitores 127-125 ndaj Brooklynit, ndeshje që u vendos në katër sekondat e fundit, pas një koshi të Leonardos (30 pikë). Në pjesën e parë ishin mysafirët ata që kishin një avantazh të lehtë (Russelli 28 pikë), por në pjesën e dytë kanadezët përmbysën shifrat, duke fituar falë 40 pikëve që u realizuan nga lojtarët e stolit. Toronto ndan kreun e renditjes bashkë me Milwaukee, që mundi pa shumë probleme 112-99 Chicago, takim i luajtur në fushën e këtij të fundit. Suksesi i 42-të sezonal për Bucksin mban sërish emrin e gjigantit Antetokounmpo, që realizoi 29 pikë e 17 rebounde. Fitore pa shumë vlera për renditjen e ekip-



it të Clevelandit, që mundi 107-104 NewYorkun, sfidë ku u dallua Sextoni me 20 pikë. Oklahoma bëhet forca e tretë në Perëndim, pas fitores 120-111 ndaj Portlandit, takim ku vendësit patën gjatë gjithë kohës epërsi në parket. Vijnë paraqitja e mirë e Georges, që realizoi një "triple double", me 47 pikë, 12 rebounde e 10 asistime. Një "triple double" realizoi edhe Westbrook me 21 pikë, 14 rebounde e 11 asistime. Kjo është dyshja e parë në historinë e NBA-së që realizon një "triple double" me mbi 20 pikë të realizuara në një ndeshje. Jo vetëm kaq, por Russell Westbrook vendos edhe

rekordin e 10 ndeshjeve radhazi në NBA që realizon një "triple double", si askush më parë. Ai theu rekordin e nëntë ndeshjeve të Wilt Chamberlain, raporton "Telesport". Nuk zhgënjën as skuadra e Denverit që klasifikohet në vendin e dytë në Perëndim. Nuggetsi mundi 103-87 Miamin, duke bërë detyrën, ndeshje ku u dalluan Beasley e Jokiçi me nga 23 pikë secili. Fiton edhe Houstoni që, falë 31 pikëve të Hardenit, mundi 120-104 Dallasin, tjetër ndeshje magjike e "mjekrës". Ndërsa Minnesota triumfoi 130-120 ndaj Clippersit, me Townsin që realizoi 24 pikë e 10 rebounde.

### REZULTATET

Cleveland - New York	107-104
Detroit - Washington	121-112
Indiana - Charlotte	99-90
Toronto - Brooklyn	127-125
Chicago - Milwaukee	99-112
Houston - Dallas	120-104
Minnesota - Clippers	130-120
Oklahoma - Portland	120-111
Denver - Miami	103-87

### SHKURT

#### Federeri: Pensionohem nëse nuk kam suksese

Roger Federeri, edhe pse 37-vjeçar, vijon ende të luajë tenis. Një karrierë e gjatë 21 vjet, ku ka triumfuar dhe ka shkruar gjithnjë emrin me të arta. Por nëse fitoret do të mungojnë, siç po ndodh në muajt e fundit, tenisti zviceran do të tërhiqet. "Unë luaj dhe dua të fitoj. Do të gënjeja po të thosha që nuk më mërzi humbja në raundet e para të një turneu. Përkundrazi, jam i zhgënjyer nga vetja. Unë nuk luaj në një turne vetëm për t'u argëtuar bashkë me publikun, por edhe për të fituar. Ose të paktën përpiqem të luaj në një nivel të caktuar", ka thënë Federeri. "Më ndodh shpesh gjatë vitit që të përballem me më të mirët, herë fitoj e herë humbas. Unë stërvitem për të fituar me të gjithë. Të fitoj ndaj atyre që janë më të mirët në botë, rivalët e mi kryesorë, është një motivim për mua. Nëse nuk do të jem më në gjendje të fitoj me ata që dominojnë këtë sport, atëherë do të tërhiqesha", ka deklaruar Federeri.

#### Ronaldo blloko transferimin e Icardit te Juve

Drejtori sportiv i Juventusit, Fabio Paratici, ka zbuluar se ata kishin qenë në mes të transferimit të Mauro Icardit nga Interi dhe Cristiano Ronaldos nga Real Madridit, por në fund kishin vendosur ta transferojnë portugezin. Ronaldo u transferua gjatë afatit kalimtar të verës së kaluar në Juventus, pasi drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" u detyruan t'ia paguajnë Real Madridit plot 112 milionë euro. "Pas bisedimeve me agjentin e Ronaldos, unë bisedova me Andrea Agnelli dhe Pavel Nedvedin dhe u thashë: E kam një ide dhe ende duhet të vlerësohet kështu që mos qeshni dhe mos e gjuani veten nga dritaret", ka thënë Paratici. "Ka dy mënyra për ta motivuar skuadrën: një të cilën s'mund ta them dhe tjetra është ta transferojmë Ronaldon. Mënyra e parë? Ishte ta blejmë Icardin dhe ta nisim një rrëmujë të mrekullueshme ose ta blejmë Ronaldon".

#### Sturridge në "radar" të Tottenhamit


Tottenham Hotspuri po monitoron me kujdes situatën e Daniel Sturridges te skuadra e Liverpoolit. Sulmuesit i mbaron kontrata në përfundim të këtij sezoni, ndërkohë që te "Gjelat" ai shihet si një alternativë për Harry Kanen, që do të ketë nevojë edhe të pushojë. Mungesa e një alternative të sulmuesit kryesor të skuadrës po ndihet aktualisht te skuadra e Pochettinos, ndaj edhe drejtuesit kanë nisur që të mendojnë që tani për afatin kalimtar të verës. Në "Anfield Road", Sturridge ka mbetur nën hijen e treshes magjike Salah-Firmino-Mane, ndërkohë që para tij preferohet edhe Divock Origi.





#### Dybala preferon Realin para Unitedit dhe Chelseat

Sulmuesi i Juventusit, Paulo Dybala, preferon kalimin në Real Madrid. Interesim për argjentinasiin kanë treguar Manchester Unitedi dhe Chelsea, por Dybala preferon më shumë kalimin në Spanjë. Nëse skuadra e Realit paguan 105 milionë funte, Dybala sezonin tjetër do të luajë në La Liga.

#### Unitedi synon transferimin e Neymarit

Manchester Unitedi raportohet se është i gatshëm ta transferojë yllin e PSG-së, Neymar, për shifër rekorde gjatë verës. Unitedi është në kërkim të një qendërmbrojtësi, por mendohet se klubi po dëshiron t'i zgjerojë edhe opsionet në sulm. Realit është i lidhur me një transferim të Neymarit që një kohë të gjatë por, sipas "DailyRecord", Unitedi do të hyjë në betejë për brazilianin. Më tej, në raportim theksohet se klubi do të ofrojë deri 230 milionë funte për ish-lojtarin e Barcelonës. 27-vjeçari ka realizuar 20 gola dhe ka asistuar 11 herë në 23 paraqitje për PSG-në këtë sezon.



						Autor: GAZMEND MORINA	RRËNIMI, SHKATËRRIMI	ISH BOKSIERI ..... LIKA	REKRUT NË KOHËN E TURQISË	"T" në mes të dy "E"	NJË NGJYRË		BAKËRPU-NUESI	ZANORE	NXËNËS I SHKOLLËS SË MESME USHTARAKE (shq.)	GRIMCË MOLEKULARE (sh.pashq.)	HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"	
						BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV												ROSAK KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO
E MBAROVA, E PËRFUNDOVA (krah.)														KALI I STËRITUR I THAVE				
USHQIM QË SHTROHET E HAHET GJATË PIJES											NIËSHTE KËNGËTARJA .... TAKE							
TEATËR NË PRISHTINË										MALLKIMI NGA KISHA PEZMATIMI I VESHIT								
LLOJ AGRUME												TEZE VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT				PRES DEGËT E TEPËRTA TË NJË PEME		
INDIUM								VEÇORIA THELBËSORE E NJË DUKURIE SHKRONJË GREKE							BASHKËT. NJË PLANET			
BASHKËT.							KITARË (bised.) LLOJ PEME E VENDEVE TROPIKALE								"URUGUA" MALI MË I LARTË NË TURQI (pashq.)			
						AKTORJA E FAMSHME SPANJOLLE NË FOTO (shqip.)	NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE	TONELATË	SHALQI	MINDERI I ULËT (vjet.)	FRIKACAKU NËNË (turq.)			LLOJ PAPANALLI BIZNESMEN				
KËPUCË TË POSAÇME PËR TË RRËSHQITUR MBI AKULL													ZANORE DY BASHKË-TINGËLLORE		NËPËR ARA, ARAVE KËNGËTARI POTOKU (Shq.)			
E EMËROVA NË NJË POZITË												KËNGËTARJA AMERIKANE GWEN FLEGËR						
SHKURTABIQI										KRYELARTË SHUFËR E FORTË DHE E GJATË METALIKE						BASHKËT. MUZIKANTI KRASNIQI		
ELI FARA								NAIM ISMAJLI FUTBOLLISTI PORTUGEZ KARVALHO (R. MADRID)		ZANORE BOSHTI		NOTË MUZIKORE NJËSIA MONETARE BAZË E SHQIPËRISË		DESPOT QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip.)			PIANIST-JA ALBERTA	
KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE FUTBOLLISTI ..... CANA											ZANORE	ROKERI KRAVITZ (shqip.) PAJTUESHM-ËRI (krah.)		MJET PËR SITJE (sh.shq.)				
➔																ISMET SYLEJMANI ANIJATA		"IRLANDA" I NDESH
EURO - DEPUTETJA GJERMANE DORIS ...								E GJYMTON GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)								AKTORI FLLOKO KRAHINË NË SHQIPËRI		
BASHKËT.							AMBASADORI I SHBA-së NË SHQIPËRI ALEKSANDËR DY ZANORE			MIRË DE (bised.)		ZULMË MBATHËSE SPORTIVE			BASHKËT. LLOJ VEPRE MUZIKORE		SHKRONJA XIX LAKESË (sh.pashq.)	
QË KA TË BËJË ME FSHATARËSINË											ZANORE TROYES	ANTON PASHKU FUTBOLLISTI CORDOBA (INTER)		FEUDALI QË I NËNSHTROHEJ MBRETIT BASHKËT.				
➔												I PËRZJEVA KËNGËTAR I FAMSHËM AMERIKAN					LUFTËTARI GJERGJ ..... ALIA	
KATROR BASHKËT.							OREGON INSTITUTE TECHNOLOGY DEM, KA					AFROJ (bised.) DY BASHKË-TINGËLLORE		TITAN, NITROGJEN OSMAN (perkdh.)			"KENIA" DEPARTMENT INDUSTRIAL RELATIONS	
						BASHKËT. SHKRONJA TË NJËJTA		AKTORJA ..... KURTI VARIOLE				KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK IKER KASILLAS			FUTBOLLISTI FRANCEZ .... RAMI (VALENCIA) DY BASHKË-TINGËLLORE			
KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT									AKTORJA ITALIANE BELLUÇI ZANORE					QYTET NË KOSOVË ZANORE				
KLUB FUTBOLLI NË KOSOVË										NANTES		ISH PORTIERI SPANJOLL SANTIAGO (VALENCIA)						



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT  
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 19 dhe të rregullit 20 të Rregullores së punës, Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores, Nr. 04/2015, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, Sekretariati shpall:

### KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

**1.**  
**Pozita:** Zyrtar për regjistrimin e lëndëve në DRLSA (1)  
**Kodi:** SP- DRLSA 02  
**Kohëzgjatja e emërimit:** I karrierës (pa afat)  
**Puna provuese:** Një (1) vit

#### Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Të vërtetojë procedurën e pranimit të kërkesave, të draftojë shkresat, të regjistrojë kërkesat e parashtruara në Gjykatë, të evidencojë shkresat në regjistrat përkatës - bazën e të dhënave, të formojë lëndët, të kopjojë shkresat e lëndëve në ekzemplarë të nevojshëm për procedim.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Bashkëpunon me Njësinë Ligjore në procedurën e pranimit të kërkesës për t'u siguruar që kërkesa është pranuar në përputhje me Ligjin dhe me Rregulloren e Gjykatës;
- Formon dosjen fizike, regjistron kërkesën në bazën elektronike të të dhënave dhe administron lëndën;
- Procedon për përkthim kërkesën dhe të gjitha shkresat e lëndës, si dhe siguron informacione për gjyqtarët dhe për Njësinë Ligjore sa i përket lëndëve;
- Shkresat e pranuar pas paraqitjes së kërkesës, i regjistron në bazën elektronike të të dhënave dhe në regjistrin e shkresave të lëndës të cilës i bashkëngjiten;
- Drafton procesverbalin e këshillimeve dhe të votimeve gjatë seancave;
- Në bazë të Rregullores së punës të Gjykatës, përpilon dhe përgatit për nënshkrim vendimet për emërimin e Gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues përkatësi me kërkesat;
- Komunikon me palët në mënyrë verbale dhe nëpërmjet telefonit dhe u përgjigjet atyre për ecurinë e kërkesës;
- Protokollon, skanon dhe procedon shkresat që u dërgohen palëve në procedurë, e që kanë të bëjnë me lëndën;
- Procedon për nënshkrim, për skanim dhe për publikim të gjitha vendimet e gjykatës në ueb-faqen e Gjykatës dhe në Gazetë Zyrtare; dhe
- Kryen edhe punë të tjera, sipas kërkesës së drejtorit të DRLSA-së.

#### Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Përgatitje universitare, fakulteti/master juridik, administratë publike, statistikë, informatikë, ose fushë të ngjashme;
- Të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune; dhe
- Njohja e gjuhës shqipe dhe serbe është e domosdoshme, kurse njohja e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Kandidati për pozitën e Zyrtarit për regjistrimin e lëndëve në DRLSA, duhet të posedojë aftësi për të ndërmarrë iniciativë dhe për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrje minimale, duke i kushtuar vëmendje të kujdesshme hollësive; aftësi për të krijuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira në punë si pjesëtar i ekipit në një mjedis shumëkulturore dhe shumetnik; aftësi të mirë ndërpersonale dhe të komunikimit; përkushtim ndaj cilësisë; aftësi për të kryer punët dhe detyrat në situata stres; gatishmëri për të punuar me orar fleksibil; aftësi organizative; aftësi të zhvilluara për hartimin e dokumenteve.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

#### Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet emailit në adresën: [lulzim.syla@gjk-ks.org](mailto:lulzim.syla@gjk-ks.org), nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 27/02/2019, deri në ora 16.00.

#### Shënim:

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit eventual të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT  
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Shodno çlani 12. Zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo, br. 03/L-121, pravilu 19. i pravilu 20. Poslovnika o radu Ustavnog suda Republike Kosovo, br. 01/2018, kao i u saglasnosti sa Uredbom br. 04/2015 o postupcima zapošljavanja, imenovanja i probnog rada za osoblje Ustavnog suda, Sekretarijat raspiše:

### KONKURS za popunu radnog mesta

**1.**  
**Mesto:** Službenik za registrovanje predmeta u ORPSA(1)  
**Kod:** SP- DRLSA 02  
**Trajanje imenovanja:** karijere (neodređeno)  
**Probni rad:** jedna (1) godina

#### Opšti opis radnog mesta:

Da potvrđuje proceduru prijema zahteva, da sastavlja dopise, da zavodi zahteve podnete Sudu, da evidentira dopise u odgovarajuće registre - bazu podataka, da formira predmete, da kopira spise predmeta u dovoljnom broju primeraka za procesuiranje.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

- saradnja sa pravnom jedinicom u proceduri prijema zahteva da bi se osiguralo da je zahtev primljen u skladu sa Zakonom i Poslovníkom o radu;
- formiranje fizičkih dosijea, zavođenje zahteva u elektronsku bazu podataka i upravljanje predmetom;
- prosledivanje zahteva i svih spisa predmeta na prevođenje, kao i obezbeđivanje informacija za sudije i pravnu jedinicu u vezi sa predmetima;
- zavođenje spisa primljenih nakon podnošenja zahteva u elektronsku bazu podataka i u registar spisa predmeta kome se prilažu;
- sastavljanje zapisnika sa većanja i glasanja tokom sednica;
- na osnovu Poslovnika o radu Suda sastavljanje i pripremanje za potpisivanje odluke o imenovanju sudije izvestioca i Veća za razmatranje u vezi sa zahtevima;
- komuniciranje sa strankama verbalno i putem telefona i odgovaranje o toku zahteva;
- zavođenje u protokol, skeniranje i procesuiranje spisa koji se dostavljaju stranama u postupku a koji se odnose na predmet;
- prosledivanje na potpisivanje, za skeniranje i objavljivanje svih odluka Suda na veb stranici Suda i u Službenom listu i
- obavljanje i drugih poslova na zahtev direktora ORPSA.

#### Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:

- univerzitetska školska sprema, pravni fakultet/master, javna uprava, statistika, informatika, ili slična oblast;
- najmanje tri (3) godine radnog iskustva; i
- poznavanje albanskog i srpskog jezika je obavezno, dok je poznavanje engleskog jezika prednost.

Kandidat za mesto Službenika za registrovanje predmeta u ORPSA treba da ima sposobnosti za preduzimanje inicijative i za rad na efektivan način pod minimalnim nadzorom i posvećujući posebnu pažnju detaljima; sposobnost da stvori i održava dobre odnose u radu, kao deo ekipe u multikulturalnoj i multietničkoj sredini; sposobnost za dobre međuljudske odnose i komuniciranje, posvećenost kvalitetu; sposobnost da obavlja poslove i zadatke u stresnim situacijama, spremnost na fleksibilno radno vreme, organizacione sposobnosti, razvijene sposobnosti u sastavljanju dokumenta.

#### Opšte informacije za kandidate

Određivanje plate za objavljeno radno mesto se vrši u skladu sa Poslovníkom o radu i odlukom Ustavnog suda.

Ustavni sud pruža jednake mogućnosti zapošljavanja i očekuje zahteve od pripadnika nevećinskih zajednica i ženskih kandidata. Politika rodne zastupljenosti i svih zajednica na Kosovu će biti sprovedena tokom procedure prijema u Ustavnom sudu Republike Kosovo.

#### Procedura konkurisanja

Zainteresovani kandidati treba da podnesu odgovarajući zahtev, kome prilažu profesionalnu biografiju, motivaciono pismo, kao i odgovarajuću dokumentaciju o školskoj spremi i potrebnom radnom iskustvu.

Zahtev se može dobiti u štampanoj formi na prijavnici Ustavnog suda i može se preuzeti sa internet stranice Ustavnog suda [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).

Zahtev i sva ostala dokumenta mogu se podneti putem elektronske pošte, na sledeću imejl adresu: [lulzim.syla@gjk-ks.org](mailto:lulzim.syla@gjk-ks.org), putem poštanske službe ili u štampanoj formi u kancelariji Odeljenja za administraciju i ljudskih resursa (OALJR) Ustavnog suda.

Poslednji datum za prijem zahteva je 27/02/2019, do 16.00 časova.

#### Napomena:

Zahtevi podneti nakon poslednjeg datuma neće biti primljeni. Nekompletni zahtevi mogu biti odbijeni. Zbog eventualnog velikog broja dostavljenih zahteva, biće kontaktirani samo kandidati koji ulaze u užu izbor.

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:  
044 248 173  
044 200 604  
044 375 333**

**American  
Taste**

**SINCE  
1905**



## NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "ROE-FIX" Sh.P.K. me seli në Istog, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810096265 dhe nr.fiskal:810096265 ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ROE-FIX" D.O.O. Istog, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810096265 broj fiskala: 810096265 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MP PHARM 000" L.L.C in Istog, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810096265 i number fiskal: 810096265, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumessedetails  
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Sokol Hajdini shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likofc.

► Fazli Hajdini shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turiqefc.

► Ramush Hajredini shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shkëndija" Hajvali Prishtinë.

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria e Mbrojtjes  
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



# BËHU REKRUT I FSK-së!

## BËHU USHTAR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

### KONKURS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës shpall konkurs për pranimin e rekrutëve të rinj – ushtarë aktivë për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 11 deri më 22 shkurt 2019.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazernat e FSK-së, si dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, [www.mksf-rks.org](http://www.mksf-rks.org), apo [www.rks-gov.net/mfsk](http://www.rks-gov.net/mfsk).

Ministria e Mbrojtjes ju shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e të rinjve pa dallim nga përkatësia e tyre etnike, gjinore dhe racore.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht në të gjitha kazernat e FSK-së,  
çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.  
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.